FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.54	2004	11 Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9256 datë 15.7.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e prodhimit dhe të ristrukturimit të sektorit të energjisë".....	3517
Ligj nr.9257 datë 15.7.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e menaxhimit të integruar të ujërave dhe ekosistemit".....	3526
Ligj nr.9258 datë 15.7.2004	Për masat kundër financimit të terrorizmit.....	3538
Ligj nr.9259 datë 15.7.2004	Për disa ndryshime në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit".....	3546
Ligj nr.9260 datë 15.7.2004	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar	3546
Vendim i Kuvendit nr.134, datë 1.7.2004	Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor	3548

Vendim i Kuvendit nr.135, datë 5.7.2004	Për një shtesë në vendimin nr.134, datë 1.7.2004 "Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor"….	3548
Vendim i Kuvendit nr.136, datë 8.7.2004	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Shërbimit Civil……	3549
Vendim i Kuvendit nr.137, datë 8.7.2004	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Konkurrencës……	3549
Vendim i Kuvendit nr.138, datë 15.7.2004	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Vitore Tusha anëtare e Gjykatës Kushtetuese……	3550
Vendim i Kuvendit nr.139, datë 22.7.2004	Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për përgatitjen e projektligjit "Për ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë"……	3550
Vendim i Kuvendit nr.140, datë 29.7.2004	Për mosmiratimin e një kandidature për anëtar të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT)……	3551
Vendim i Kuvendit nr.141 datë 29.7.2004	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT)……	3551
Vendim i Kuvendit nr.142 datë 29.7.2004	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT)……	3551
Vendim i KM nr.491, datë 23.7.2004	Për shpërndarjen me koeficient të vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë "KAMBERI CO" sh.p.k., në administrim me të ardhurat e realizuara nga shitja e aseteve……	3552
Udhëzim i KM nr.3, datë 18.3.2004	Për format dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit nga organet, që licencojnë personat fizikë dhe juridikë, në funksion të procesit të parandalimit të pastrimit të parave……	3553
Autorizim zyrtar i Komisionit të Mbikqyrjes së Sigurimeve nr.7, datë 8.7.2004	Për të vepruar si shoqëri sigurimi……	3557
Udhëzim i MRRTT nr.2, datë 19.7.2004	Mbi përcaktimin dhe plotësimin e modelit të regjistrit të shërbimit të varrimit……	3557
Udhëzim i MRRTT nr.3, datë 28.07.2004	Për administrimin e ujit të pijshëm……	3560

LIGJ
Nr.9256, datë 15.7.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË SË ZHVILLIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E PRODHIMIT DHE TË RISTRUKTURIMIT TË SEKTORIT TË ENERGJISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e prodhimit dhe të ristrukturimit të sektorit të energjisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4279, datë 26.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
E KREDISË PËR ZHVILLIM (PROJEKTI I PRODHIMIT DHE I RISTRUKTURIMIT TË SEKTORIT TË ENERGJISË) NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM, 6 PRILL 2004

Marrëveshje, datë 6 prill 2004 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (shoqata).

Meqenëse A) Huamarrësi, duke qenë i bindur për mundësinë e realizimit dhe prioritetin e projektit të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), ka kërkuar nga Shoqata që ta ndihmojë në financimin e projektit;

B) Huamarrësi ka si qëllim të garantojë kontratën që do të lidhet nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) për një hua në një shumë të barabartë, por jo më të vogël se tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë dollarë (37 500 000 USD) (Huaja BERZH), që do të ndihmojë në financimin e pjesës A të projektit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet KESH dhe BERZH (Marrëveshja e huasë BERZH);

C) Huamarrësi ka si qëllim që të garantojë kontratën që do të lidhet nga Banka Europiane për Investim (BEI) me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) për një hua në një shumë të barabartë, por jo më të vogël se tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë dollarë (37 500 000 USD) (Huaja BEI), që do të ndihmojë në financimin e pjesës A të projektit, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet KESH dhe BEI (Marrëveshja e huasë BEI);

D) Projekti do të zbatohet nga KESH me ndihmën e Huamarrësit dhe si pjesë e kësaj ndihme, Huamarrësi do t'i transferojë KESH-it shumat e kredisë të pasqyruara në nenin II të kësaj Marrëveshjeje (Kredia), siç përcaktohet në këtë Marrëveshje dhe,

meqenëse Shoqata ka pranuar, në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, që të japë kredi tek Huamarrësi sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në marrëveshjen në po këtë datë ndërmjet Shoqatës dhe KESH (Marrëveshja e projektit),

palët bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

Seksioni 1.01 "Kushtet e përgjithshme për t'u zbatuar në marrëveshjet e kredisë për zhvillim" të Shoqatës, nënshkruar më datën 1 janar 1985 (ndryshuar më 6 tetor 1999), (Kushtet e përgjithshme), përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara këtu më poshtë dhe termat plotësues që pasojnë kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "PMM" i referohet planit të menaxhimit të mjedisit, e pëlqyeshme për Shoqatën, aprovuar nga KESH më 24 tetor 2003, ku përcaktohen masat për të ulur ndikimet negative për mjedisin dhe masat monitoruese për projektin, siç mund të amendohet herë pas here me miratimin e Shoqatës;

b) "Fondi ballancues" do të thotë një fond që do të krijohet nga KESH, me qëllim që fitimet që rezultojnë nga kushtet e favorshme hidrologjike të ruhen në këtë fond për të mbuluar koston e importit të energjisë elektrike në rastet e kushteve jo të mira hidrologjike;

c) "ERE" do të thotë Enti Rregullator i Energjisë i krijuar sipas kushteve të ligjit "Për sektorin e energjisë" nr.9072, datë 22 maj 2003;

d) "Raporti monitorues financiar" ose RMF do të thotë raporti i përgatitur në përputhje me seksionin 4.02 të marrëveshjes së projektit;

e) "KESH" do të thotë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, një kompani autonome e krijuar në përputhje me kushtet e ligjit nr.7926, datë 20 prill 1995;

f) "Lek" do të thotë monedha e Huamarrësit;

g) "LIBOR" do të thotë interesi ndërbankar londinez për depozitat gjashtëmujore në dollarë;

h) "PZP" do të thotë plani i zbatimit të projektit, datë 17 dhjetor 2003 siç mund të ndryshohet herë pas here nëpërmjet marrëveshjes mes Shoqatës dhe KESH-it;

i) "Memorandumi i mirëkuptimit", për tregun rajonal të energjisë në Europën Juglindore do të thotë memorandumi i mirëkuptimit i datës 8 dhjetor 2003, nënshkruar nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Republika e Turqisë, Serbisë dhe Malit të Zi, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Kosovës dhe Komuniteti Europian, që parashtron angazhimin dhe procesin e pjesëmarrësve për të përmirësuar sektorin e energjisë të rajonit të Europës Juglindore dhe për të krijuar një treg për energjinë dhe gazin në rajonin e Europës Juglindore;

j) "Kuadri i politikave" do të thotë kuadri i politikave për blerjen e tokës i miratuar nga KESH-i më 9 dhjetor 2003, ku parashtrohen procedurat dhe kërkesat për blerjen e tokës për krijimin e kullave për linjën e transmetimit;

k) "Plani i veprimeve të sektorit të energjisë "do të thotë plani i miratuar nga Huamarrësi në 24 dhjetor 2003, që përcakton veprimet dhe objektivat për përmirësimin e performancës së sektorit të energjisë për periudhën nga 1 janari 2004 deri në 31 dhjetor 2006 dhe rishikimet vjetore të mëvonshme të pranueshme për Shoqatën;

l) "Dokumenti i politikave të sektorit të energjisë do të thotë dokumenti i miratuar nga Këshilli i Ministrave i Huamarrësit më 19 prill 2002, siç mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshjen e Shoqatës;

m) "Marrëveshja e projektit" do të thotë marrëveshja midis Shoqatës dhe KESH-it të po kësaj date, siç mund të ndryshohet herë pas here dhe të tilla kushte përfshijnë të gjitha skedulet dhe marrëveshjet shtesë të marrëveshjes së projektit;

n) “Llogaria speciale” do të thotë llogaria që i referohet seksionit 2.02(b) të kësaj Marrëveshjeje;

(o) “Marrëveshja e nënhuasë” do të thotë marrëveshja që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe KESH-it sipas seksionit 3.01(b) të kësaj Marrëveshjeje, siç mund të ndryshohet herë pas here dhe të tilla kushte përfshijnë të gjitha shtojcat e marrëveshjes së nënhuasë dhe termi “nënhua” do të thotë nënhuaja që do të transferohet sipas marrëveshjes së nënhuasë.

Neni 2
Kredia

Seksioni 2.01 Shoqata pranon t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e kredisë për zhvillim, një shumë në valuta të ndryshme baras me gjashtëmbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë të Drejta Speciale Tërheqëse (SDR 16 900 000).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose nëse Shoqata do të bjerë dakord ndryshe, për t’u kryer) për kosto të arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga shumat e kredisë.

b) Huamarrësi, për nevojat e projektit mund të hapë dhe të mbajë një llogari depozite speciale në dollarë në një bankë me kushte dhe kondita të pranueshme për Shoqatën, duke përfshirë mbrojtjen e duhur nga konfiskimi ose ndalimi. Depozitat në dhe pagesat nga Llogaria Speciale do të bëhen në përputhje me dispozitat e shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03 Data e mbylljes është 31 janar 2008 ose një datë e mëvonshme që e përcakton Shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do t’i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi shumën principale të kredisë së patërhequr nga koha në kohë me një vlerë të caktuar nga Shoqata duke filluar më 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar vlerën e një gjysmë përqindëshi (1/2 të 1%) në vit.

b) Pagesa e angazhimit do të rritet: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje (data rrjedhëse) deri në datat respektive në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga llogaria e kredisë ose do të anulohen dhe (ii) në interesin e caktuar më 30 qershor menjëherë para datës rrjedhëse dhe me një interes tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Interesi i caktuar më 30 qershor në çdo vit do të aplikohet nga data pasuese në atë vit që specifikohet në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Pagesa e angazhimit do të paguhet: (i) në ato vende që Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë; (ii) pa kufizime të çfarëdolloji që mund të imponohen nga, ose në territorin e Huamarrësit; (iii) në monedhë të përcaktuar në këtë Marrëveshje për nevojat e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do t’i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi me një interes prej tre të katërtat e një përqindëshit (3/4 e 1%) në vit të shumës principale të kredisë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Seksioni 2.06 Pagesat e angazhimit dhe pagesat e shërbimeve do të paguhen dy herë në vit më 1 maj dhe 1 shtator të çdo viti.

Seksioni 2.07 Huamarrësi do të shlyejë shumën principale të kredisë në këstet 6-mujore çdo 1 maj dhe 1 shtator duke filluar nga 1 shtator 2014 dhe duke përfunduar më 1 mars 2024. Çdo këst duhet të jetë 5 për qind (5%) e shumës principale.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për qëllimet e seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3
Zbatimi i projektit

Seksioni 3.01 (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit të përcaktuara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe, për këtë qëllim, pa ndonjë kufizim apo pengim të detyrimeve të tjera të tij sipas Marrëveshjes së kredisë për zhvillim, do të sigurojë që KESH të kryejë, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së projektit, të gjitha detyrimet e përcaktura, do të ndërmarrë ose do të sigurojë që të ndërmerren të gjitha veprimet, përfshirë sigurimin e fondeve, pajisjeve, shërbimeve dhe burimeve të tjera të nevojshme ose të përshtatshme për të bërë të mundur që KESH t'i realizojë këto detyrime dhe nuk do të ndërmarrë ose nuk do të lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që do të parandalonte ose do të ndërhynte në kryerjen e detyrimeve të tilla.

b) Huamarrësi do t'ia huazojë shumat e kredisë KESH-it sipas marrëveshjes së nënhuasë që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe KESH-it sipas kushteve dhe konditave, të cilat janë miratuar nga Shoqata dhe që përfshijnë termat dhe kushtet kryesore të specifikuara në paragrafin (c) të këtij seksioni.

c) Kushtet kryesore të marrëveshjes së nënhuasë janë: (i) periudha e shlyerjes së nënhuasë do të jetë 20 vjet, duke përfshirë një periudhë grace prej 5 vjetësh; (ii) interesi mbi shumën e nënhuasë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë do të jetë në një përqindje, që azhurnohet çdo gjashtë muaj, e barasvlefshme me interesin mesatar të LIBOR plus zero pikë shtatëdhjetë e pesë për qind (0.75%); (iii) nënhuaja do të jetë në lekë; (iv) shuma e principalit të nënhuasë që do t'i shlyhet Huamarrësit, do të jetë ekuivalenti në lekë i shumës së nënhuasë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë, ekuivalenti i të cilit do të jetë nga data ose datat përkatëse të tërheqjeve të shumave nga llogaria e kredisë në llogarinë e shpenzimeve të bëra nga KESH.

d) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij në zbatim të marrëveshjes së nënhuasë në një mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Shoqatës dhe të përmbushë qëllimet e kredisë dhe, përveçse Shoqata bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk do të caktojë, ndryshojë, do të shfuqizojë ose heqë dorë nga marrëveshja e nënhuasë ose nga çdo kusht i saj.

Seksioni 3.02 Përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, i punimeve dhe shërbimet e konsulentëve të nevojshëm për projektin dhe që do të financohen nga shumat e kredisë, do të kryhen në përputhje me dispozitat e shtojcës 1 të marrëveshjes së projektit.

Seksioni 3.03 Për qëllimet e seksionit 9.06 të kushteve të përgjithshme dhe pa kufizim, Huamarrësi:

a) do të përgatisë, në bazë të udhëzuesve të pranueshëm nga Shoqata, dhe të pajisë Shoqatën jo më vonë së gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes, ose më vonë se kjo datë siç mund të jetë rënë dakord për këtë qëllim ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës, me një plan për aktivitetin e projektit në të ardhmen; dhe

b) do të t'i japë Shoqatës një mundësi për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin për planin në fjalë.

Seksioni 3.04 Me pëlqimin paraprak të Shoqatës, Huamarrësi do të azhurnojë më 30 nëntor të çdo viti, planin e veprimit të sektorit të energjisë.

Seksioni 3.05 Huamarrësi:

a) do të sigurojë pagesë të plotë dhe të menjëhershme të faturave të energjisë elektrike të ndërmarrjeve buxhetore dhe shtetërore; dhe

b) deri në 31 dhjetor 2005, do të eliminojë të gjitha detyrimet e prapambetura të ndërmarrjeve shtetërore dhe buxhetore, në përputhje me planin e veprimeve të sektorit të energjisë.

Seksioni 3.06 Huamarrësi:

a) në 15 dhjetor të çdo viti, do të miratojë masat e rëna dakord me Shoqatën, për uljen e impaktit të rritjes së energjisë tek shtresat në nevojë;

b) do të zbatojë masa të tilla në vitin pasardhës.

Seksioni 3.07 Huamarrësi do të sigurojë se të gjitha licencat dhe lejet që kërkohen për ndërtimin e TEC-it në Vlorë sipas pjesës A të projektit, lëshohen në një kohë të përshtatshme.

Seksioni 3.08 Huamarrësi deri më 30 shtator 2004 do të zhvillojë dhe do të miratojë një procedurë të pëlqyeshme për Shoqatën, për dhënien e koncesioneve të nënstacioneve hidrologjike.

Neni 4
Konventat financiare

Seksioni 4.01 (a) Huamarrësi do të bëjë të mundur që KESH të ketë sistemin e menaxhimit financiar, duke përfshirë llogaritë dhe regjistrimet dhe të përgatisë pasqyrat financiare, të gjitha në përputhje me standardet e zbatueshme të kontabilitetit të pranueshme për Shoqatën, të përshtatshme që të reflektojë burimet, veprimtaritë dhe shpenzimet që lidhen me projektin. Për të gjitha shpenzimet në lidhje me të cilat janë bërë tërheqjet nga llogaria e Kredisë bazuar në dokumentet e shpenzimeve:

b) Huamarrësi:

i) do të mbajë dokumentet dhe llogaritë referuar në paragrafin (a) të këtij seksioni për çdo vit fiskal të audituar (ose periudhë tjetër siç mund të bjerë dakord Shoqata), në përputhje me parimet e duhura audituese të aplikuara me përpikmëri, nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Shoqatën;

ii) do të pajisë Shoqatën menjëherë, sapo të jenë të gatshme, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti (ose ndonjë periudhë tjetër siç mund të bjerë dakord Shoqata), (A) kopje të vërtetuara të pasqyrave financiare që i referohen paragrafit (a) të këtij seksioni për një vit të tillë (ose ndonjë periudhë tjetër siç mund të bjerë dakord Shoqata), të audituara dhe (B) një opinion të audituesit lidhur me këto pasqyra, sipas qëllimit dhe i detajuar që të jetë i kënaqshëm për Shoqatën; dhe

iii) do të pajisë herë pas here Shoqatën me informacione të tjera lidhur me dokumentet, llogaritë dhe auditimet e këtyre pasqyrave financiare, nga auditorët e përmendur, siç mund ta kërkojë Shoqata herë pas here.

c) Për të gjitha shpenzimet, lidhur me tërheqjet e bëra nga llogaria e kredisë mbi bazën e pasqyrave të shpenzimeve, Huamarrësi:

i) do të sigurojë që të gjitha dokumentet (kontratat, kërkesat, faturat, vërtetimet dhe dokumente të tjera që vërtetojnë këto shpenzime të ruhen të paktën për një periudhë njëvjeçare, pasi Shoqata të ketë marrë raportin e auditimit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e kredisë;

ii) do të mundësojë përfaqësuesit e Shoqatës që t'i kontrollojnë këto dokumente;

iii) do të sigurojë se këto pasqyra të shpenzimeve përfshihen në çdo auditim që Shoqata mund të ketë kërkuar sipas paragrafit (b) të këtij seksioni.

Neni 5
Masat ndëshkuese të Shoqatës

Seksioni 5.01 Në përputhje me seksionin 6.02(1) të kushteve të përgjithshme përcaktohen rastet e mëposhtme kur:

a) KESH do të ketë dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjes së projektit.

b) Si rezultat i ngjarjeve, të cilat kanë ndodhur mbas datës së Marrëveshjes së kredisë për zhvillim, janë krijuar situata të pazakonta të cilat bëjnë të pamundur që KESH të ketë mundësi të realizojë detyrimet e tij sipas marrëveshjes së projektit.

c) Huamarrësi do të ketë dështuar të zbatojë masat e parashikuara në memorandumin e mirëkuptimit për tregun e energjisë rajonale në Europën Juglindore.

d) Ligji, vendimi, statuti ose ndonjë dokument tjetër i themelimit të KESH-it, përfshirë ndonjë dekretim ligjor apo rregullues mbi të cilat janë të bazuar instrumente të tilla, ose ndonjë licencë dhënë KESH-it lidhur me projektin, do të ndryshohej, pezullohej, abrogohej, shfuqizohej ose nxirrej jashtë përdorimit, pasi ndikojnë materialisht dhe negativisht, mbi mundësinë e KESH-it për të përmbushur detyrimet e tij sipas marrëveshjes së projektit.

e) Huamarrësi do të ketë dështuar të zbatojë masat e rekomanduara në dokumentin e politikave në sektorin e energjisë.

(f) (i) Sipas nënparagrafit (ii) të këtij paragrafi:

A) e drejta e KESH-it për të tërhequr shumat e huasë së BERZH-it dhe/ose BEI, të dhëna KESH-it dhe të garantuara nga Huamarrësi për financimin e projektit do të jenë pezulluar, anuluar ose mbaruar pjesërisht ose plotësisht, sipas kushteve të marrëveshjes së huasë me BERZH-in dhe/ose marrëveshjes së huasë me BEI, përkatësisht, duke siguruar për ketë; ose

B) Huaja e BERZH-it dhe/ose huaja e BEI do të jenë të vlefshme dhe të pagueshme përpara datës së maturimit të rënë dakord.

(ii) Nënparagrafi (i) i këtij paragrafi do të zbatohet nëse Huamarrësi, sipas pëlqimit të Shoqatës, përcakton se: (A) pezullimi, anulimi, mbarimi ose paramaturimi nuk shkaktohen nga dështimi i KESH-it ose Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas marrëveshjes së tillë; dhe (B) Huamarrësi ka fonde të mjaftueshme nga burime të tjera me terma dhe kushte në përputhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Në përputhje me seksionin 7.01(h) të kushteve të përgjithshme, kushtet e mëposhtme shtesë përcaktohen:

a) rasti i përcaktuar në paragrafin (a) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej 60 ditësh mbas njoftimit bërë Huamarrësit nga Shoqata;

b) do të ndodhë ndonjë nga rastet e specifikuara nga paragrafët (c), (d) dhe (e) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) do të ndodhë rasti i specifikuar në paragrafët (f), (i)(B) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje, sipas kushteve të paragrafit (1)(ii) të atij seksioni.

Neni 6
Data e hyrjes në fuqi, përfundimi

Seksioni 6.01 Rastet e mëposhtme janë përcaktuar si kushte shtesë për efektivitetin e Marrëveshjes së kredisë për zhvillim në kuadër të përcaktimit të seksionit 12.01(b) të kushteve të përgjithshme.

a) Marrëveshja e nënhuasë është ekzekutuar në emër të Huamarrësit dhe KESH-it; dhe marrëveshja e huasë me BERZH-in është ekzekutuar dhe lëshuar dhe se janë përmbushur të gjitha kushtet paraprake të efektivitetit ose të drejtat e KESH-it për të bërë tërheqje, me përjashtim të efektivitetit të Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit dhe;

b) Marrëveshja e huasë me BEI është ekzekutuar dhe lëshuar dhe se janë përmbushur të gjitha kushtet paraprake të efektivitetit ose të drejtat e KESH-it për të bërë tërheqje, me përjashtim të efektivitetit të Marrëveshjes së kredisë së zhvillimit.

Seksioni 6.02 Çështjet e mëposhtme janë përcaktuar si shtesë brenda kuptimit të seksionit 12.02(b) të kushteve të përgjithshme, për t'u përfshirë në opinionin ose opinionet me të cilat do të pajiset Shoqata:

a) që marrëveshja e projektit është autorizuar ose ratifikuar në kohë nga KESH dhe i është detyruar ligjërisht KESH-it në përputhje me kushtet e saj; dhe

b) që marrëveshja e nënhuasë është autorizuar ose ratifikuar siç duhet nga Huamarrësi dhe KESH dhe i është detyruar ligjërisht Huamarrësit dhe KESH-it në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 6.03 Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7
Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Seksioni 7.01 Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllime të seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tirana Albania
Faks: 35542 28495

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W., Washington, D.C. 20433
United States of America
Teleks INDEVAS 248423 (MCI) ose (202)477-6391
Washington, D.C. 64145 (MCI)

Para dëshmitarëve, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në distriktin e Kolumbias, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën dhe vitin e lartshënuar për herë të parë.

SHQIPËRIA

Nga. Arben Malaj
Ministër i Financave
Përfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga Nadir Mohammed
Drejtor i Misionit të Bankës Botërore-Tiranë
Përfaqësuesi i autorizuar

SHTOJCA 1
TËRHEQJA E SHUMAVE TË KREDISË

1. Tabela e mëposhtme përcakton kategoritë e zërave që do të financohen nga shumat e kredisë, shpërndarjen e shumave të kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për zërat që do të financohen në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (shprehur në SDR të barasvleshme)	% e shpenzimeve për të financuar
1. Mallra (duke përfshirë kontratën e furnizimit dhe instalimit)	14,100,000	19.5%
2. Shërbimet e konsulentëve	2,730,000	85%
3. Trajnime	70,000	100%
Totali	16,900,000	

2. Për nevojat e kësaj shtojce, termi "trajnime" nënkupton shpenzimet e bëra nga KESH, në lidhje me kryerjen e aktiviteteve të trajnimit në kuadër të projektit, përfshirë kostot e udhëtimit dhe dietat për instruktorët dhe të trajnuarit, për udhëtimet e studimit dhe seminaret, qiratë e mjeteve dhe pajisjeve, për materialet e trajnimit dhe pajisjet lidhur me të.

3. Pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 1 më sipër, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për pagesat bërë për shpenzime para datës së kësaj Marrëveshjeje.

4. Shoqata mund të kërkojë të bëhen tërheqje nga llogaria e kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzimet sipas kontratave për: (a) shërbime të firmave konsulente për kontrata që nuk e kalojnë shumën 100 000 $ ekuivalent dhe (b) për trajnime, të gjitha sipas kushteve dhe konditave që do të përcaktojë Shoqata duke e njoftuar Huamarrësin.

SHTOJCA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është përmirësimi i performancës së sistemit të energjisë nëpërmjet: (1) investimeve prioritare me qëllim rritjen e prodhimit termal; dhe (2) masat për të zbatuar reformat në sektor dhe fuqizimi institucional.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme që janë objekt i ndryshimeve që herë pas here Huamarrësi dhe Shoqata mund të bien dakord për realizimin e këtyre objektivave:

Pjesa A: Stacioni i energjisë me cikël të kombinuar

1. Ndërtimi i një TEC-i me një cikël të kombinuar në stacionin e Vlorës (impianti i fuqisë termale në Vlorë) në një hapësirë rreth 6 hektarë tokë rreth 6 km në veri të Vlorës afër pontilit të furnizimit me lëndë djegëse.

2. Rehabilitimi i pontilit të furnizimit me lëndë djegëse dhe lidhja e TEC-it me rrjetin e transmetimit.

Pjesa B: Asistenca teknike

1. Asistencë teknike për KESH-in për zbatimin e projektit, përmirësimin e veprimtarisë së KESH-it dhe reformat në sektor.

2. Trajnime për punonjësit e KESH-it për prokurimet dhe menaxhimin e mjedisit.

Projekti parashikohet të përfundojë deri më 31 korrik 2007.

SHTOJCA 3
LIOGARIA SPECIALE

1. Për qëllimet e kësaj shtojce:

a) termi "kategori të pranueshme" nënkupton kategoritë (2) deri (3) të paraqitura në tabelën në paragrafin 1 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

b) termi "shpenzime të pranueshme" nënkupton shpenzime lidhur me koston e arsyeshme të mallrave dhe të shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga shumat e kredisë të shpërndara herë pas here në kategori të pranueshme sipas kushteve të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

c) termi "shpërndarje e autorizuar" nënkupton një shumë ekuivalente me $ 500 000 që do të tërhiqet nga llogaria e kredisë dhe depozitohet në Llogarinë Speciale sipas paragrafit 3 (a) të kësaj shtojce, me kusht që, përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, shpërndarja e autorizuar do të kufizohet në shumën ekuivalente deri në $ 250 000 deri sa shuma totale e tërheqjeve nga llogaria e kredisë plus shumën totale të gjithë angazhimit special të papaguar të Shoqatës, sipas seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme do të jetë e barabartë ose kalon ekuivalentin prej SDR 1 000 000.

2. Pagesat nga Llogaria Speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të pranueshme në përputhje me kushtet e kësaj shtojce.

3. Pasi Shoqata ka marrë një evidencë të pranueshme për të se Llogaria Speciale është hapur në kohën e duhur, do të bëhen tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar dhe tërheqjet pasuese për të rimbushur Llogarinë Speciale, si më poshtë:

a) Për tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës një kërkesë apo kërkesa për depozitë në Llogarinë Speciale të një shume ose të shumave, të cilat nuk e kalojnë shumën totale të shpërndarjes së autorizuar. Mbi bazën e një kërkese apo kërkesave të tilla, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe depozitojë në Llogarinë Speciale këtë shumë apo shumat e kërkuara nga Huamarrësi.

b) (i) Për rimbushjen e Llogarisë Speciale, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës kërkesa për depozita në Llogarinë Speciale në intervalet që do të specifikojë Shoqata.

(ii) Përpara ose në kohën e çdo kërkese të tillë, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës dokumentet dhe evidenca të tjera të kërkuara sipas paragrafit 4 të kësaj shtojce, për pagesën apo pagesat në lidhje me çdo rimbushje të kërkuar. Mbi bazën e çdo kërkese të tillë, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe depozitojë në Llogarinë Speciale shumën e kërkuar nga Huamarrësi dhe të provuar në dokumentet dhe evidencat e tjera që janë paguar nga Llogaria Speciale për shpenzime të pranueshme. Të gjitha këto depozita do të tërhiqen prej Shoqatës nga llogaria e kredisë sipas kategorive respektive të pranueshme dhe në lidhje me shumat ekuivalente të justifikuara nga dokumentet apo evidencat e tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nga Llogaria Speciale, Huamarrësi, në kohën që Shoqata në mënyrë të arsyeshme do t'ia kërkojë, do të pajisë Shoqatën me dokumente dhe evidenca të tjera të tilla që tregojnë se pagesa të tilla janë bërë ekskluzivisht për shpenzime të arsyeshme.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3 të kësaj shtojce, Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozita të mëtejshme në Llogarinë Speciale:

a) nëse, në ndonjë rast Shoqata ka vendosur që gjithë tërheqjet e mëtejshme të bëhen prej Huamarrësit direkt nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e nenit V të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

b) nëse Huamarrësi nuk ka arritur t'i paraqesë Shoqatës, brenda afatit të specifikuar në seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e auditimit të kërkuar për t'iu paraqitur Shoqatës, sipas seksionit në fjalë, lidhur me kontrollin e dokumenteve dhe llogarive për Llogarinë Speciale;

c) nëse në ndonjë rast Shoqata ka njoftuar Huamarrësin se ka ndërmend të ndalojë plotësisht apo pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e kredisë, sipas kushteve të seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme;

d) sapo shuma totale e patërhequr e kredisë së shpërndarë në kategoritë e përshtatshme, minus shumën totale të të gjithë angazhimit special të papaguar nga Shoqata sipas seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme përsa i përket projektit, do të barazojë ekuivalentin e dyfishit të shumës së shpërndarjes së autorizuar.

Si pasojë, tërheqja nga llogaria e kredisë e shumës së mbetur të patërhequr prej kredisë së shpërndarë në kategoritë e pranuara do të ndjekë procedura të tilla të cilat do t'i specifikojë Shoqata duke njoftuar Huamarrësin. Tërheqje të tilla të mëtejshme do të bëhen vetëm pasi, dhe deri në atë masë që Shoqata do ta shikojë të arsyeshme që shuma të tilla të mbetura në depozitë në Llogarinë Speciale deri në datën e një njoftimi të tillë, do të përdoren për të bërë pagesa për shpenzime të pranueshme.

6. a) Nëse Shoqata do të përcaktonte në ndonjë rast që ndonjë pagesë nga Llogaria Speciale: (i) do të bëhej për një shpenzim ose në një shumë që nuk përputhet me paragrafin 2 të kësaj shtojce; ose (ii) nuk justifikohet nga evidencat e paraqitura Shoqatës, Huamarrësi sapo të marrë njoftimin nga Shoqata: (A) do të sigurojë evidenca shtesë që mund të kërkojë Shoqata; ose (B) do të depozitojë në Llogarinë Speciale (ose, nëse Shoqata do të kërkojë rifinancim për Shoqatën) një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë apo pjesën jo aq të pranueshme apo të justifikuar. Përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, nuk do të bëhet asnjë depozitë e mëtejshme nga Shoqata në Llogarinë Speciale derisa Huamarrësi t'i sigurojë këto evidenca ose të bëjë një depozitim të tillë apo rifinancim, sipas rastit.

b) Nëse Shoqata në ndonjë rast ka përcaktuar se një shumë e papaguar në Llogarinë Speciale nuk do të kërkohet për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzimet e pranueshme, Huamarrësi, sapo të marrë njoftimin nga Shoqata, do t'ia kthejë Shoqatës këtë shumë të papaguar.

c) Huamarrësi me njoftim nga Shoqata, mund t'ia kthejë asaj të gjitha apo një pjesë të fondeve të depozituara në Llogarinë Speciale.

d) Kthimet e bëra Shoqatës sipas paragrafit 6 (a), (b) dhe (c) të kësaj shtojce do t'i kreditohen llogarisë së kredisë për tërheqje të mëvonshme ose për anulim, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë kushtet e përgjithshme.

LIGJ
Nr.9257, datë 15.7.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË UJËRAVE DHE EKOSISTEMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e menaxhimit të integruar të ujërave dhe ekosistemit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4280, datë 26.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA
E GRANTIT TRUST FUND I GEF (FONDI GLOBAL PËR MJEDISIN)
(PROJEKTI PËR ADMINISTRIMIN E INTEGRUAR TË UJËRAVE DHE EKOSISTEMEVE) NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SI AGJENCI IMPLEMENTUESE E FONDIT GLOBAL TË MJEDISIT

Marrëveshja e datës 26 prill 2004, ndërmjet Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), që vepron si agjenci zbatuese e Global Environment Facility (GEF) për sa u përket fondeve të grantit të siguruara nga Trusti i Fondeve të GEF-it nga disa anëtarë të Bankës si pjesëmarrës të GEF-it.

A) Banka, në bazë të Rezolutës nr.91-5 të 14 marsit 1991 të drejtorëve ekzekutivë të Bankës themeloi GEF-in për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit global dhe promovimin prej këtej të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe të shëndoshë për mjedisin.

B) Duke ndjekur ristrukturimin e GEF-it, marrëveshje të tilla vazhduan mbi bazat e parashtruara në Rezolutën nr.94-2 të 24 majit l994 të drejtorëve ekzekutivë të Bankës, të cilët, *inter alia*, themeluan Fondin e Trustit të GEF-it dhe caktuan Bankën si të Ngarkuarën e Trustit të Fondit të GEF-it (Rezoluta nr.94-2).

C) Seria e dytë e Trustit të Fondit të GEF-it u aprovua mbi bazat e parashtruara në Rezolutën nr.98-2 të 14 qershorit 1998 të drejtorëve ekzekutivë të Bankës (Rezoluta nr.98-2).

D) Seria e tretë e Trustit të Fondit të GEF-it u aprovua mbi bazat e parashtruara në Rezolutën nr.2002-0005 të 19 dhjetorit 2002 të drejtorëve ekzekutivë të Bankës (Rezoluta nr.2002-0005)

E) Marrësi, pasi e konsideron të përshtatshëm dhe prioritar projektin e përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti), ka kërkuar asistencë nga burimet e Fondit të Trustit të GEF-it, dhe kjo kërkesë është aprovuar në përputhje me provizionet e Instrumentit për Themelimin e Facilitetit të Mjedisit Global të Ristrukturuar të aprovuar në bazë të Rezolutës 94-2 dhe që do të financohet nga kontributet e Trustit të Fondit të GEF-it sipas Rezolutës nr.2002-0005, që mund të përfshijë fonde të serisë së parë dhe të dytë të Trustit të Fondit të GEF-it sipas Rezolutave nr.94-2 dhe 98-2.

F) Me një marrëveshje të datës 22 dhjetor 2003 ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve (EIB) dhe Marrësit (Marrëveshja e Huasë së EIB), EIB-i ka rënë dakord t'i akordojë Marrësit një hua në shumën prej shtatëdhjetë e tre milionë e dyqind mijë euro (EUR 73 200 000) (Huaja e EIB) për të asistuar në financimin pjesës A të projektit me termat dhe kushtet e parashtruara në Marrëveshjen e Huasë së FIB dhe

ndërsa Banka ka rënë dakord, në bazë të, *inter alia*, sa u tha më sipër, t'i kalojë Marrësit grantin e Trustit të Fondeve të GEF-it sipas termave dhe kushteve të parashtruara në këtë Marrëveshje,

tani Palët këtu bien dakord si vijon:

Neni 1

Kushte të përgjithshme, përcaktime

Seksioni 1.01 (a) Provizionet e mëposhtme të kushteve të përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e huave dhe garancive të Bankës të datës 1 janar 1985, me modifikimet e parashtruara në paragrafin (b) të këtij seksioni (Kushtet e përgjithshme) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

i) Artikulli I

ii) Seksionet 2.01 (1), (2), (3), (4), (6), (8), (9), (10), (11), (15), (18) dhe (20), 2.02 dhe 2.03;

iii) Seksioni 3.01;

iv) Seksioni 4.01 dhe fjalia e parë e seksionit 4.09;

v) Artikulli V;

vi) Seksionet 6.01, 6.02 (c), (e), (f), (i) dhe (k), 6.03, 6.04 dhe 6.06;

vii) Seksioni 8.01 (b);

viii) Seksionet 9.01 (a) dhe (c), 9.04, 9.05, 9.06, 9.07. 9.08 dhe 9.09;

ix) Seksionet 10.01, 10.03 dhe 10.04;

x) Artikulli XI dhe

xi) Seksionet 12.01, 12.02, 12.03 dhe 12.04.

b) Kushtet e përgjithshme do të modifikohen si vijon:

i) Termi "Banka", sa herë që të përdoret në kushtet e përgjithshme, përveçse në seksionet 2.01(8) dhe 6.02(f) dhe përdorimit të fundit të këtij termi në seksionin 5.01, do të thotë se Banka që vepron si agjenci zbatuese e GEF-it, përveçse në seksionin 6.02; termi "Bankë" gjithashtu do të përfshijë Bankën që vepron në kapacitetet e saj.

ii) Termi "Huamarrësi" kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme do të thotë Marrësi"

iii) Termi "Marrëveshja e Huasë" kudo që të përdoret në kushtet e përgjithshme do të thotë kjo Marrëveshje.

iv) Termi "Huaja" dhe "huaja", kudo që të përdoret në kushtet e përgjithshme do të thotë grant i Fondit të GEF-it.

v) Termi "Llogarija e Huasë", kudo që përdoret në kushtet e përgjithshme do të thotë Llogaria e Grantit të Fondit të GEF-it.

vi) Fjalia e dytë e seksionit 5.01 modifikohet si vijon:

"Përveçse atëherë kur Banka dhe Marrësi do të bien dakord ndryshe nuk do të ketë tërheqje: (a) në lidhje me shpenzimet në territoret e çdo vendi që nuk është anëtar i Bankës ose për mallrat e prodhuara në, ose shërbimet e ofruara nga territore të tilla ose (b) për qëllim të çdo pagese personave ose njësive, ose për çdo import mallrash, në qoftë se një pagesë ose import i tillë, me sa

ka dijeni Banka, është e ndaluar nga ndonjë vendim i Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara i marrë në bazë të kapitullit VII të "Kartës së Kombeve të Bashkuara" dhe

vii) një nënparagraf i ri shtohet pas nënparagrafit (j) në seksionin 6.02 të kushteve të përgjithshme, si vijon:

"do të jetë krijuar një situatë e jashtëzakonshme në të cilën çdo disbursim i mëtejshëm nga Fondet e Trustit të GEF-it do të tejkalonte burimet në dispozicion për disbursim nga GEF-i."

Seksioni 1.02. Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje, përveçse atëherë kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e ndryshëm të përcaktuar në kushtet e përgjithshme dhe në recitalet e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të parashtruara dhe termat vijuese kanë kuptimet e mëposhtme:

a) "EMP" do të thotë plani i menaxhimit të mjedisit, i kënaqshëm për Bankën, adoptuar nga Marrësi dhe i paraqitur Bankës me 8 tetor 2003, duke parashtruar masa për mënjanimin e çdo efekti të dëmshëm ndaj mjedisit.

b) "PIP" do të thotë plani i zbatimit të projektit për kryerjen e projektit, përgatitur dhe adapuar nga Marrësi, në të njëjtën kohë mund të amendohet herë pas here në marrëveshje me Bankën.

c) "PIU" do të thotë njësia e zbatimit të projektit themeluar nga Marrësi për qëllim të menaxhimit dhe koordinimit të Projektit dhe

d) "Special Account" do të thotë llogaria së cilës i referohemi në seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Granti i Fondit të GEF-it

Seksioni 2.01. Banka bie dakord që t'i ofrojë Marrësit, me termat dhe kushtet parashtruara ose të referuara në këtë Marrëveshje, grantit të Trustit të GEF-it shumën katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë dollarë amerikanë (4 870 000 $).

Seksioni 2.02. (a) Sasia e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it mund të tërhiqet nga llogaria e grantit të Trustit të GEF-it në përputhje me provizionet e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose, në qoftë se Banka do të bjerë dakord që të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e projektit dhe që do të financohen nga granti i Trustit të Fondit të GEF-it.

b) Marrësi mundet që, për qëllimet e projektit, të hapë dhe të mbajë në dollarë një llogari depozituese speciale në një bankë me terma dhe kushte të kënaqshme për Bankën, duke përfshirë mbrojtje të përshtatshme kundër dëmtimeve. Depozitat në, dhe pagesat prej llogarisë speciale do të bëhen në përputhje me provizionet e shtojcës 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03. Data e mbylljes do të jetë 31 dhjetor 2009 ose një datë e mëvonshme që do të vendosë Banka. Banka do të njoftojë në kohën e duhur Marrësin për një datë të tillë të mëvonshme.

Neni 3
Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Marrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit siç janë parashtruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe me këtë qëllim, do të zbatojë projektin nëpërmjet PIU-t me diligjencë dhe efikasitet dhe në përputhje me praktika të përshtatshme administrative, financiare dhe inxhinierike dhe duke marrë në konsideratë, ashtu siç duhet, faktorët ekologjikë dhe mjedisorë dhe do të ofrojë, në kohën e nevojshme, fondet, facilitetet, shërbimet dhe burime të tjera të kërkuara nga projekti.

b) Pa kufizuar provizionet e paragrafit (a) të këtij seksioni dhe përveç rastit kur Marrësi dhe Banka do të bien dakord ndryshe, Marrësi do të zbatojë projektin në përputhje me PIP-in dhe programin e zbatimit të parashtruar në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Përveçse kur Banka do të bjerë dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulencës të kërkuara nga pjesët A.1, B, C dhe D të projektit dhe që

do të financohen nga granti i Trustit të Fondit të GEF-it do të qeveriset nga provizionet e shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllimet e seksionit 9.08 të kushteve të përgjithshme dhe pa kufizim për to, Marrësi:

a) do të përgatisë, në bazë të parimeve të pranueshme për Bankën, dhe do t'i paraqesë Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes ose një datë të mëvonshme siç mund të bihet dakord ndërmjet Marrësit dhe Bankës një plan për operimin e ardhshëm të projektit dhe

b) do t'i ofrojë Bankës një rast të arsyeshëm për shkëmbimin e pikëpamjeve në lidhje me planin e mësipërm me Marrësin.

Neni 4
Kushtet financiare

Seksioni 4.01. (a) Marrësi do të mbajë një sistem të menaxhimit financiar, duke përfshirë regjistra dhe llogari dhe do të përgatisë dokumentet financiare në përputhje me standardet financiare të zbatuara në mënyrë konsistente dhe të pranueshme për Bankën, të përshtatshme për të pasqyruar operacionet, burimet dhe shpenzimet e lidhura me projektin.

b) Marrësi:

i) do të auditojë dokumentet financiare të referuara në paragrafin të këtij seksioni për çdo vit fiskal (ose periudhë tjetër të rënë dakord nga Banka), në përputhje me standardet audituese të zbatuara në mënyrë konsistente dhe të pranueshme për Bankën, nga auditues të pranueshëm për Bankën;

ii) do t'i paraqesë Bankës sa më shpejt që të jenë të gatshme, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të çdo viti të tillë (ose çdo periudhe tjetër të tillë të rënë dakord nga Banka): (A) kopje të noteruara të dokumenteve financiare të referuara në paragrafin (a) të këtij seksioni për një vit të tillë (ose periudhë tjetër të rënë dakord nga Banka), kështu të audituara, dhe (B) një opinion mbi dokumente të tilla nga audituesit e sipërpërmendur, me qëllim dhe detaje të kënaqshme për Bankën dhe

iii) do t'i paraqesë Bankës çdo informacion tjetër të tillë, që ka lidhje me regjistra dhe dokumente të tilla, dhe auditimin e dokumenteve të tilla financiare dhe të lidhura me audituesit të tillë, ashtu siç mund të kërkojë Banka herë pas here të mënyrë të arsyeshme.

c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me të cilat janë bërë tërheqje nga llogaria e Huasë bazuar në rregullat e shpenzimeve, Marrësi:

i) do të ruajë, deri një vit pas marrjes së raportit të auditimit nga Banka për, apo që mbulon vitin fiskal në të cilin është kryer tërheqja e fundit nga llogaria e Trustit të Fondit të GEF-it të gjithë dokumentet (kontrata, urdhëresa, fatura, fletëmarrje dhe dokumente të tjera) që evidentojnë shpenzime të tilla;

ii) do të bëjë të mundur pjesëmarrjen e përfaqësusit të Marrësit në ekzaminimin e dokumenteve të tilla dhe

iii) do të sigurojë që vërtetime të tilla të shpenzimeve të përfshihen në auditim për çdo vit fiskal (ose çdo periudhë tjetër, të rënë dakord nga Banka) referuar në paragrafin (b) të këtij seksioni.

Neni 5
Zhdëmtimet e Bankës

Seksioni 5.01. Në zbatimin të seksionit 6.02. të kushteve të përgjithshme, specifikohen ngjarjet shtesë të mëposhtme:

a) PIP-i do të amendohet, pezullohet, shfuqizohet ose heqë dorë pa lejen paraprake të Bankës.

b) (i) Subjekt ndaj nënparagrafit (ii) të këtij paragrafi:

A) e drejta e Marrësit për të tërhequr procedimet e huasë së EIB-së për financimin e Projektit do të jetë pezulluar, fshirë ose përfunduar pjesërisht ose tërësisht, në bazë të termave të Marrëveshjes së Huasë së EIB-së ose

B) Huaja e EIB-së do të ketë arritur afatin ose është bërë e pagueshme përpara se të kenë rënë dakord.

ii) Nënparagrafi (i) i këtij paragrafi nuk do të aplikohet në qoftë se Marrësi vendos dhe Banka është e kënaqur se:

A) ndalesa, fshirja, përfundimi ose prematurimi nuk është shkaktuar nga dështimi i Marrësit për të kryer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe

B) fonde të përshtatshme për projektin i ofrohen Marrësit nga burime të tjera sipas termash dhe kushtesh konsistente me detyrimet e Marrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Efektiviteti, përfundimi

Seksioni 6.01. Ndodhia e mëposhtme specifikohet si konditë e efektivitetit të grantit të Trustit të Fondit të GEF-it brenda kuptimit të seksionit 12.01(c) të kushteve të përgjithshme, specifikisht, që Marrëveshja e Huasë së EIB-së është autorizuar apo ratifikuar në kohën e duhur nga Marrësi dhe është ligjërisht shtrënguese ndaj Marrësit në përputhje me termat e saj.

Seksioni 6.02. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje specifikohet këtu për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 6.03. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të jetë efektive deri sa granti i Trustit të Fondit të GEF-it të jetë disbursuar plotësisht dhe palët e kësaj Marrëveshjeje të kenë plotësuar detyrimet që rrjedhin prej saj.

Neni 7

Përfaqësuesit e Marrësit, adresat

Seksioni 7.01. Ministria e Financave e Marrësit caktohet si përfaqësues i Marrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

Për Marrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Shqipëri
Faksimile: 355 42 28494

Për Bankën:
International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street. N.W:
Washington, D.C. 20433
United States of America
Cable address:
INTBAFRAD
Washington, D.C.
Telex: 248423 (MCI)
64145 (MCI)

SHTOJCA I

TËRHEQJA E PROCEDIMEVE TË GRANTIT TË TRUSTIT TË FONDIT TË GEF-IT

1. Tabela e mëposhtme parashtron kategoritës e çfarë financohet nga procedimet e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it, shpërndarjen e sasive të grantit të Trustit të Fondit të GEF-it në çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për çfarë do të financohet në secilën kategori

Kategoria	Sasia e grantit të Fondit të GEF-it (shprehur në dollarë amerikanë)	% e shpenzimeve që do të financohen
(1) Punime	3 281 000	85%
(2) Mallra	170 000	100% e shpenzimeve të huaja
		100% e shpenzimeve lokale (kosto në fabrikë) dhe 75% e shpenzimeve lokale për të tjera gjëra të prokuruara lokalisht
(3) Shërbime konsulence	578 000	85%
(4) Trajnime	43 000	100%
(5)Kosto operative	68 000	75%
(6) Të paalokuara	730 000	
Totali	4 870 000	

2. Për qëllimet e kësaj shtojce:

a) Termi "shpenzime të huaja" do të thotë shpenzime në monedhën e çdo vendi të ndryshëm nga ai i Marrësit për mallra ose shërbime të furnizuara nga territori i çdo vendi të ndryshëm nga ai i Marrësit;

b) Termi "shpenzime lokale" do të thotë shpenzime në monedhën e Marrësit ose për malira e shërbime të furnizuara nga territori i Marrësit;

c) Termi "trajnim" do të thotë trajnim dhe udhëtime studimi të ofruara individëve ose grupeve, të lidhura me: (a) menaxhimin dhe operimin e ligatinave artificiale të trajtimit; (b) menaxhimin e lagunave natyrore dhe zonave të mbrojtura; (c) komunikimin me publikun dhe aktivitete propagandistike në lidhje me shërbimet e mbetjeve ujore dhe mbrojtjen e mjedisit dhe

d) termi "kosto operative" do të thotë shpenzime operative të kryera nga PIU për llogari të menaxhimit të zbatimit të projektit për komunikim, pajisje, printime dhe publikime, qira zyre, mirëmbajtje dhe furnizim, sisteme sigurie zyre, operim dhe mirëmbajtje makine, transport dhe shpenzime për udhëtime në terren, trajnim të stafit të PIU-t për qëllim të menaxhimit të projektit, shpërblime për stafin, duke përfshirë taksat sociale, por duke përjashtuar pagat e shërbyesve civilë dhe auditimet dhe të tjera shpenzime, të tilla siç mund të bihet dakord me Bankën.

3. Pavarësisht nga provizionet e paragrafit 1 më lart, nuk do të bëhen tërheqje në lidhje me pagesat e bëra për shpenzime para datës së kësaj Marrëveshjeje.

4. Banka mund të kërkojë tërheqje nga llogaria e Fondit të GEF-it të bëhen në bazë të faturave të shpenzimeve për shpenzime për: (a) mallra të kontraktuara që kushtojnë më pak se 100 000$ ekuivalentë secili; (b) punime të kontraktuara që kushtojnë më pak se 500 000$ ekuivalentë secili; (c) shërbime të firmave konsulente të kontraktuara që kushtojnë më pak se 100 000$ ekuivalentë secili; (d) shërbime të konsulentëve individualë të kontraktuara që kushtojnë më pak se 50 000$ ekuivalentë secili; (e) trajnime dhe (f) kostot operative, nënterma dhe kushte të tilla që Banka do të specifikojë dhe të vërë në dijeni Marrësin.

5. Nëse Banka do të ketë vendosur në çdo kohë se ndonjë pagesë e bërë nga llogaria e Fondit të GEF-it është përdorur për ndonjë shpenzim jokonsistent me provizionet e kësaj Marrëveshjeje, Marrësi, me të marrë njoftim nga Banka, do t'i rikalojë fondet Bankës për depozitim në llogarinë e Fondit të GEF-it në një sasi të njëjtë me sasinë e kështupërdorur ose një pjese të saj siç specifikohet nga Banka.

SHTOJCA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është të përmirësojë shërbimet e mbetjeve ujore në zonat bregdetare të Marrësit.

Projekti konsiston në pjesët që vijojnë, subjekt i modifikimeve të tilla siç mund të bien dakord Marrësi dhe Banka herë pas here për arritjen e objektivave të tillë.

Pjesa A: Pakësimi i ndotjes së ujërave të zeza

1. Vendosja e ligatinave artificiale të trajtimit dhe faciliteteve të lidhura me to në zonat bregdetare të Durrësit, Lezhës dhe Sarandës.

2. Ndërtimi i kolektorëve kryesorë të ujërave të zeza për lidhjen e sistemit ekzistues të ujërave të zeza me facilitetet e reja trajtuese.

3. Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjeteve të ujërave të zeza.

Pjesa B: Menaxhimi dhe monitorimi i mjedisit

1. Zhvillimi i një plani të menaxhimit të rezervës së menaxhimit të Kune Vainit të Marrësit (Plani i menaxhimit të Kune Vainit), që përfshin një plan për pjesëmarrjen e grupeve të interesuara në menaxhimin e burimeve natyrore dhe stimuj ekonomikë për vazhdueshmëri afatgjatë.

2. Trajnimi i grupeve të interesuara të përfshira në projekt në fushën e menaxhimit të burimeve natyrore, menaxhim të integruar ekosistemesh, monitorim të mjedisit, menaxhim dhe operim të ligatinave artificiale të trajtimit, komunikim publik dhe shpërndarje të informacionit.

3. Përmirësimi i kushteve të mjedisit të rezervës së menaxhuar të Kune Vainit dhe zonave të tjera bregdetare, mjedisi i të cilave ndikohet nga projekti, duke përfshirë zbatimin e masave të përzgjedhura prioritare të identifikuara në planin e menaxhimit të Kune Vainit.

4. Zhvillmi dhe zbatimi i programeve të monitorimit për cilësinë e ujit dhe indikatatorët e biodiversitetit në: (a) rezervën e menaxhuar të Kune Vainit të Marrësit dhe (b) zonat bregdetare mjedisi i të cilave ndikohet nga projekti.

Pjesa C: Informimi publik

1. Kryerja e procesit të konsultimit me palët e interesuara për përgatitjen dhe zbatimin e planit të menaxhimit të Kune Vainit.

2. Projektimi dhe zbatimi i fushatave të sensibilizimit mbi qëllimet e projektit dhe përfitimet e një menaxhimi të integruar të ekosistemit, rolin e komuniteteve lokale dhe përgjegjësitë në menaxhimin e burimeve natyrore.

3. Trajnimi dhe organizimi i seminareve mbi aspektet teknike, ekonomike dhe mjedisore të ligatinave artificiale dhe menaxhimit të integruar të ekosistemit.

4. Projektimi dhe zbatimi: (a) i edukimit mjedisor dhe program komunikimi për komunitetet lokale dhe (b) i një programi pilot të trajnimit të mësuesve në ekologji dhe edukim mjedisor në shkolla të përzgjedhura.

5. Zhvillimi i një strategjie replikimi, që përfshin përgatitjen e projekteve të ngjashme, identifikimin e vendeve dhe metodat e përhapjes së informacionit.

Pjesa D: Menaxhimi i projektit

Forcimi i aftësisë menaxhuese të PIU-t, Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit për monitorimin, administrimin dhe vlerësimin e zbatimit të projektit.

Projekti pritet të përfundojë në 30 qershor 2009.

SHTOJCA 3
PROKURIMI DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni I. Prokurimi i mallrave dhe punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me provizionet e seksionit I të “Udhëzimeve për prokurim sipas Huave të IBDR-së dhe kredive të IDA-s”, botuar nga Banka në

janar 1995 dhe rishikuar në gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999 (Udhëzimet) dhe provizioneve të mëposhtme të seksionit I të kësaj shtojce.

Pjesa B: Tenderimi kompetitiv ndërkombëtar

1. Përveçse kur ofrohet ndryshe në pjesën C të këtij seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në përputhje me provizionet e seksionit 11 të udhëzimeve dhe të paragrafit 5 të shtojcës I këtu.

2. Provizionet e mëposhtme do të zbatohen për mallrat dhe punimet që do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në përputhje me provizionet e paragratit 1 të kësaj pjese B.

a) Preferenca për mallrat e prodhuara në vend

Provizionet e paragrafëve 2.54 dhe 2.55 të udhëzimeve dhe apendiksit zbatohen për mallra të prodhuara në territorin e Marrësit.

a) Vënia në dijeni dhe publikimi

Ftesa për parakualifikim ose tender për çdo kontratë të vlerësuar që kushton 10 000 000$ ekuivalentë ose më tepër do të publikohet në përputhje me procedurat që zbatohen për kontratat e mëdha sipas paragrafit 2.8 të udhëzimeve.

Pjesa C: Procedura të tjera prokurimi

1. Tenderimi kompetitiv kombëtar

a) Të përgjithshme

Punimet që vlerësohen se kushtojnë më pak se 500 000$ ekuivalentë për kontratë mund të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve.

b) Përmirësimi i procedurave të tenderit

Me qëllim që të sigurohet ekonomi, efikasitet, transparencë dhe konsistencë e gjerë me provizionet e seksionit I të udhëzimeve:

i) ftesa për tender do të reklamohet lokalisht në gazetat rajonale dhe në të paktën 2 gazeta kombëtare me tirazh të gjerë, të paktën 30 ditë përpara afatit të dorëzimit të ofertave;

ii) tenderuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga tenderimi dhe asnjë preferencë e çfarëdo lloji nuk do t'u jepet tenderuesve vendas në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen të tenderojnë vetëm nëse janë autonome ligjërisht dhe financiarisht dhe punojnë në bazë të ligjit tregtar të huamarrësit;

iii) tenderimi nuk do të kufizohet në firmat e pararegjistruara;

iv) njësitë prokuruese do të përdorin dokumentet e tenderit të aprovuara nga Shoqata përpara dhënies së tyre tenderuesve;

v) ofertat do të hapen në publik në një vend, menjëherë pas afatit për dorëzimin e ofertave në prezencë të përfaqësuesve të tenderuesve;

vi) ofertat nuk do të përjashtohen thjesht mbi bazën e krahasimit me një vlerësim zyrtar pa bashkëpunimin e mëparshëm të Bankës;

vii) në rast përgjigjeje të më pak se tre ofertash, të gjitha ofertat mund të përjashtohen pa bashkërendim të mëparshëm me Bankën;

viii) një procedurë me një zarf do të përdoret për dorëzimin e ofertave;

ix) paskualifikimi do të kryhet vetëm mbi ofertën me vlerë më të ulët; asnjë ofertë nuk do të përjashtohet në momentin e hapjes së ofertave mbi baza kualifikuese;

x) tenderuesit që kontraktojnë si "Joint Venture", do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht;

xi) tenderuesve mund t'u kërkohet që të dorëzojnë garanci tenderi në një vlerë të përshtatshme për shumën e vlerësuar të kontratës dhe në një formë të pranueshme për Marrësin;

xii) përpara se të mos pranohen të gjitha ofertat dhe të kërkohen oferta të reja, duhet të arrihet më parë bashkërendimi me Shoqatën;

xiii) kontratat do të lidhen me tenderuesin me vlerë më të ulët dhe që përmbush thelbësisht kushtet, që është i vendosur të kualifikohet për të punuar në përputhje me kriteret e vlerësimit të paracaktuara dhe të bëra të ditura më parë;

xiv) negociatat pastenderuese nuk do të lejohen me tenderuesin me vlerë më të ulët ose me ndonjë tenderues tjetër dhe

xv) kontratat me kohë të gjatë (më tepër se 18 muaj) do të përmbajnë provizione të përshtatshme të rregullimit të çmimeve.

2. Blerjet ndërkombëtare

Mallrat që vlerësohen se kushtojnë më pak se 75 000$ ekuivalentë për kontratë, mund të prokurohen me kontrata të lidhura në bazë të procedurave të blerjeve ndërkombëtare në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

3. Blerjet kombëtare

Mallrat që vlerësohen se kushtojnë më pak se 50 000$ ekuivalentë për kontratë, mund të prokurohen me kontrata të lidhura në bazë të procedurave të blerjeve kombëtare, në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të udhëzimeve.

4. Prokurimi i punimeve të vogla

Punimet që vlerësohen se kushtojnë më pak se 100 000$ ekuivalentë secili, mund të prokurohen me kontrata me shumë të përgjithshme dhe çmime fikse, të lidhura në bazë të kuotimeve të marra nga tre (3) kontraktorë të kualifikuar kombëtarë në përgjigje të një ftese me shkrim. Ftesa duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të punimeve duke përfshirë specifikimet bazë, datën e kërkuar të përfundimit, një formë bazë marrëveshjeje të pranueshme për Bankën dhe projektet e duhura, atje ku janë të nevojshme. Kontrata do të lidhet me kontraktorin që ofron çmimin më të ulët për punimet e kërkuara dhe që ka eksperiencën dhe burimet për të përfunduar kontratën me sukses.

Pjesa D: Rishikimi i vendimeve prokuruese nga Banka

1. Planifikimi i prokurimeve

Përpara dërgimit të çfarëdo ftese për ofertat për tender, Bankës do t'i dërgohet propozimi i planit të prokurimeve për rishikim dhe aprovim, në përputhje me provizionet e paragrafit 1 të apendiksit 1 të udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të ndërmerret në përputhje me një plan të tillë prokurimesh që do të aprovohet nga Banka dhe me provizionet e paragrafit 1 të sipërpërmendur.

2. Rishikimi paraprak

a) Në lidhje me: (i) çdo kontratë për mallra të vlerësuara që kushtojnë 100 000$ ekuivalentë ose më tepër; (ii) çdo kontratë për punime të vlerësuara që kushtojnë 500 000$ ekuivalentë ose më tepër dhe (iii) dy kontratat e para që do të prokurohen në përputhje me procedurat e referuara në pjesën C më sipër, do të zbatohen procedurat e parashtruara në paragrafët 2 dhe 3 të apendiksit 1 të udhëzimeve.

b) Në lidhje me: (i) çdo kontratë që do të prokurohet në përputhje me procedurat e referuara në pjesën C.3 më sipër dhe (ii) dy kontratat e para që do të prokurohen në përputhje me procedurat e referuara në pjesët C.2 dhe C.4 më sipër, do të zbatohen procedurat që vijojnë:

i) përpara zgjedhjes së çfarëdo furnizuesi/ekzekutori të çdo kontrate sipas procedurave të blerjes. Marrësi do t'i ofrojë Bankës një raport mbi krahasimin dhe evaluimin e kuotave të marra;

ii) përpara ekzekutimit të çfarëdo kontrate të prokuruar sipas procedurave të blerjes, Marrësi do t'i paraqesë Bankës një kopje të specifikimeve dhe draftin e kontratës dhe

iii) do të zbatohen procedurat e parashtruara në 2(f), 2(g) dhe 3 të apendiksit 1 të udhëzimeve.

3. Pasrishikimi

Për çdo kontratë që nuk qeveriset nga paragrafi 2 i kësaj pjese, do të zbatohen procedurat e parashtruara në paragrafin 4 të apendiksit 1 të udhëzimeve.

Seksioni II. Punësimi i konsulentëve

Pjesa A: Të përgjithshme

Shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në përputhje me provizionet e seksioneve I dhe IV të "Udhëzimeve: Zgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore", botuar nga Banka në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997, janar 1999 dhe maj 2002 (Udhëzimet e konsulentit), paragrafi 1 i apendiksit I atje, apendiksi 2 dhe provizionet që vijojnë të seksionit II të kësaj shtojce.

Pjesa B: Zgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto

Përveçse kur ofrohet ndryshe në pjesën C të këtij seksioni, shërbimet e konsulencës do të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me provizionet e seksionit II të udhëzimeve të

konsulentit dhe provizioneve të paragrafëve 3.13 deri 3.18 të zbatueshme për zgjedhjen e bazuar në cilësi dhe kosto të konsulentëve.

Pjesa C: Të tjera procedura për zgjedhjen e konsulentëve

1. Zgjedhja e bazuar në cilësi

Shërbimet e vlerësuara që kushtojnë më pak se 150 000$ ekuivalente për kontratë mund të prokurohen me kontrata "të lidhura në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.1 deri 3.4 të udhëzimeve të konsulentit.

2. Zgjedhja nën një buxhet fiks

Shërbime që vlerësohen se kushtojnë më pak se 200 000$ ekuivalentë për kontratë mund të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.1 deri 3.5 të udhëzimeve të konsulentit.

3. Zgjedhja e kostos më të ulët

Shërbimet për detyra të një natyre rutinë e standard të vlerësuara që kushtojnë më pak se 100 000$ ekuivalentë për kontratë mund të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.1 dhe 3.6 të udhëzimeve të konsulentit.

4. Zgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentit

Shërbimet e vlerësuara që kushtojnë më pak se 100 000$ ekuivalentë për kontratë mund të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me provizionet e paragrafëve 3.1 dhe 3.7 të udhëzimeve të konsulentit.

5. Konsulentë individualë

Shërbimet e konsulentëve individualë për detyra që plotësojnë kërkesat e parashtruara në paragrafin 5.1 të udhëzimeve të konsulentit do të prokurohen me kontrata të lidhura në përputhje me provizionet e paragrafëve 5.1 deri 5.3 të udhëzimeve të konsulentit.

Pjesa D: Rishikimi i zgjedhjes së konsulentëve nga Banka

1. Plani i përzgjedhjes

Një plan për zgjedhjen e konsulentëve, që do të përfshijë vlerësimin e kostos së kontratës, paketën e kontratës dhe kriteret dhe procedurat e zgjedhjes që do të zbatohen, do t'i paraqitet Bankës për rishikim dhe aprovim përpara çdo kërkese për propozime ndaj konsulentëve. Zgjedhja e të gjitha shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me një plan të tillë zgjedhjeje që do të jetë aprovuar nga Banka.

2. Rishikimi paraprak

a) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e firmave konsulente e vlerësuar të kushtojë 100 000 $ ekuivalentë ose më tepër, do të zbatohen procedurat e parashtruara në paragrafët 2, 3 dhe 5 të apendiksit 1 të udhëzimeve të konsulentit.

b) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e konsulentëve individualë që do të zgjidhen mbi bazën e një burimi të vetëm, ose të vlerësuara që kushtojnë 50 000$ ekuivalentë ose më tepër, Bankës do t'i paraqiten raporti për krahasimin e kualifikimit dhe eksperiencës së kandidatëve, kualifikimet, eksperiencën, termat e referencës dhe termat e punësimit të konsulentit, për rishikim paraprak dhe aprovim. Kontrata do të lidhet vetëm pasi një aprovim i tillë do të jetë dhënë. Gjithashtu, provizionet e paragrafit 3 të apendiksit 1 të udhëzimeve të konsulentit do të zbatohen në kontrata të tilla.

3. Pasrishikimi

Në lidhje me çdo kontratë që nuk qeveriset nga paragrafi 2 i kësaj pjese, do të zbatohen procedurat e parashtruara në paragrafin 4 të apendiksit 1 të udhëzimeve të konsulentit.

SHTOJCA 4
PROGRAMI I ZBATIMIT

1. Marrësi:

a) do të zhvillojë politika dhe procedura të përshtatshme që t'i mundësojnë atij të monitorojë dhe vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me tregues të pranueshëm për Bankën, zbatimin e projektit dhe arritjen e objektvave të tij;

b) do të përgatisë, sipas termave të referencës të përshtatshme për Bankën dhe do t'i paraqesë Bankës, më ose rreth 30 qershorit 2006, një raport të integruar të rezultateve të aktiviteteve monitoruese dhe vlerësuese të kryera në zbatim të paragrafit (a) të këtij seksioni, mbi progresin e arritur në zbatimin e Projektit gjatë periudhës që i paraprin datës së një raporti të tillë dhe që vë në dukje masat e rekomanduara për të siguruar zbatimin efiçent të projektit dhe objektivave të tij gjatë periudhës që pason këtë datë; dhe

c) do të rishikojë bashkë me Bankën, deri më 30 shtator 2006, ose një datë të mëvonshme siç mund të kërkojë Banka, raportin të cilit i referohet paragrafi (b) i këtij seksioni dhe, prej andej, të marrë të gjitha masat e kërkuara për të siguruar përfundimin efiçent të projektit dhe arritjen e objektivave, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e një raporti të tillë dhe pikëpamjes së Bankës mbi këtë çështje.

2. Marrësi do të sigurojë që të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e EMP-së do të ndërmerren në kohën e duhur.

3. Marrësi gjatë gjithë kohës do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që një operator i kualifikuar do të mbahet në punë mbi bazë kohore për operimin e ligatinave artificiale të trajtimit sipas pjesës A. 1 të projektit për të bërë të mundur operimin e tyre efikas.

4. Deri më 31 mars 2005, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit i Marrësit do të ketë nxjerrë aprovimin për vendin e ndërtimit dhe lejen e ndërtimit për projektin.

SHTOJCA 5
LLOGARIA SPECIALE

1. Për qëllimet e kësaj shtojce:

a) termi "kategori të përshtatshme" do të thotë kategoritë (1) deri (5) të parashtruara në tabelën e paragrafit 1 të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

b) termi "shpenzime të përshtatshme" do të thotë shpenzime në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga granti i Fondit të Trustit të GEF-it shpërndarë herë pas here sipas kategorive të përshtatshme në provizionet e shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe

c) termi "shpërndarje e autorizuar" do të thotë një shumë ekuivalente me 500 000$ për t'u tërhequr nga llogaria e grantit të Fondit të Trustit të GEF-it dhe për t'u depozituar në llogarinë speciale sipas paragrafit 3(a) të kësaj shtojce, duke e konsideruar të dhënë megjithatë që, përveçse kur Banka do të bjerë dakord ndryshe, shpërndarja e autorizuar do të kufizohet në një sasi 250 000$ ekuivalentë deri sa shuma totale e tërheqjeve nga Llogaria e Grantit të Fondit të Trustit të GEF-it bashkë me sasinë totale të të gjitha angazhimeve speciale të cilat ka ndërmarrë Banka në ndjekje të seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme, do të jetë e barabartë ose do të tejkalojë 800 000$ ekuivalentë.

2. Pagesat nga llogaria speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzimet e përshtatshme në përputhje me provizionet e kësaj shtojce.

3. Pasi Banka të ketë marrë prova të kënaqshme se llogaria speciale është hapur ashtu sic duhet, tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar dhe tërheqjet pasuese për të rimbushur llogarinë speciale do të bëhen si më poshtë:

a) Për tërheqjet e shpërndarjes së autorizuar, Marrësi do t'i paraqesë Bankës një kërkesë ose kërkesa për depozitimin e llogarinë speciale të një shume ose shumash që nuk e kalojnë sasinë totale të shpërndarjes së autorizuar. Në bazë të kësaj kërkese apo kërkesave, Banka në këmbë të Marrësit, do të tërheqë nga slogaria e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it dhe do të depozitojë në llogarinë speciale një sasi apo sasitë e tilla sipas kërkesës së Marrësit.

b) (i) Për rimbushjen e llogarisë speciale, Marrësi do t'i paraqesë Bankës kërkesën për depozitim në llogarinë speciale në intervale të tilla që do të specifikojë Banka.

ii) Më parë se ose në momentin e çdo kërkese të tillë, Marrësi do t'i paraqesë Bankës dokumentet dhe provat e tjera të kërkuara në bazë të paragrafit 4 të kësaj shtese për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat është kërkuar rimbushja. Në bazë të çdo kërkese të tillë, Banka, në

këmbë të Marrësit, do të tërheqë nga llogaria e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it dhe do të depozitojë në llogarinë speciale një shumë të tillë siç ka kërkuar Marrësi dhe siç është treguar nga dokumentet e përmendura dhe provat e tjera që janë paguar nga llogaria speciale për shpenzime të përshtatshme. Të gjitha depozitat e tilla do të tërhiqen nga Banka nga llogaria e grantit të Fondit të Trustit të GEF-it sipas kategorive përkatëse të përshtatshme dhe në shumat ekuivalente përkatëse, siç do të jetë justifikuar në dokumentet e sipërpërmendura dhe provat e tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Marrësi nga llogaria speciale, Marrësi, në një kohë të tillë siç do të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme, do t'i paraqesë Bankës dokumente të tilla dhe prova të tjera që tregojnë që pagesa të tilla janë bërë ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme.

5. Pavarësisht nga provizionet e paragrafit 3 të kësaj shtojce, Bankës nuk do t'i kërkohet më të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë speciale:

a) nëse, në çdo kohë, Banka do të ketë vendosur se çdo tërheqje e mëtejshme duhet të bëhet nga Marrësi drejtpërdrejt nga llogaria e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it në përputhje me provizionet e artikullit V të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

b) nëse Marrësi ka dështuar që t'i paraqesë Bankës, brenda periudhës së kohës së specifikuar në seksionin 4.01 b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e auditimit të kërkuara për t'iu paraqitur Bankës bazuar në seksionin e sipërpërmendur në lidhje me auditimin e dokumenteve dhe 1logarive për llogarinë speciale;

c) nëse, në çfarëdo kohe, Banka do të ketë njoftuar Marrësin se ka ndërmend të pezullojë në tërësi ose pjesërisht të drejtën e Marrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it në zbatim të provizioneve të Seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme ose

d) atëherë kur sasia totale e tërhequr nga Granti i Trustit të Fondit të GEF-it shpërndarë kategorive të përshtatshme, minus sasinë totale të të gjitha angazhimeve të jashtëzakonshme speciale të ndërmarra nga Banka në bazë të seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme në lidhje me projektin, do të barazohen me ekuivalentin e dyfishit të sasisë së shpërndarjes së autorizuar.

Atëherë e tutje, tërheqja nga llogaria e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it e sasisë së mbetur pa tërhequr nga granti i Trustit të Fondit të GEF-it shpërndarë sipas kategorive të përshtatshme do të ndjekë procedura të tilla siç do të specifikojë Banka në njoftimin ndaj Marrësit. Tërheqje të tilla të mëtejshme do të bëhen vetëm pas dhe në atë shtrirje në të cilën Banka do të ketë mbetur e kënaqur se të gjitha sasitë e tilla të mbetura në depozitën e llogarisë speciale deri në datën e një njoftimi të tillë do të përdoren në kryerjen e pagesave për shpenzime të përshtatshme.

6. (a) Nëse Banka do të ketë vendosur në çdo kohë që ndonjë pagesë nga llogaria speciale: (i) është bërë për një shpenzim ose në një sasi jo të përshtatshme sipas paragrafit 2 të kësaj shtojce ose nuk ishte e justifikuar nga provat e paraqitura Bankës, Marrësi menjëherë me njoftimin nga Banka: (A) do të ofrojë prova të tilla shtesë siç mund të kërkojë Banka ose (B) do të depozitojë në llogarinë speciale (ose, nëse Banka do të kërkojë kështu, do të rimbursojë Bankën) në një sasi të barabartë me sasinë e një pagese të tillë ose pjesës që nuk është e përshtatshme ose e justifikuar. Përveçse kur Banka do të bjerë dakord ndryshe, nuk do të bëhet depozitim i mëtejshëm deri sa Marrësi të ketë paraqitur prova të tilla ose të ketë bërë një depozitim ose rimbursim të tillë, sipas rastit.

b) Nëse Banka do të ketë vendosur në çdo kohë që çdo sasi e prapambetur në llogarinë speciale nuk do të jetë e nevojshme për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzime të përshtatshme, Marrësi, menjëherë me njoftim nga Banka, do të rimbursojë Bankën me një sasi të tillë të prapambetur.

c) Marrësi mundet që, me njoftim nga Banka, të rimbursojë Bankën me të gjithë ose çfarëdo pjese të fondeve të depozituar llogarinë speciale.

d) Rimbursimet ndaj Bankës të bëra në bazë të paragrafëve 6(a), (b) dhe (c) të kësaj shtojce do të kreditohen në llogarinë e grantit të Trustit të Fondit të GEF-it për tërheqje të mëvonshme ose për anulim në përputhje me provizionet e përshtatshme të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë kushtet e përgjithshme.

LIGJ
Nr.9258, datë 15.7.2004

PËR MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pikat 1 e 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPË RISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton masat kundër financimit të terrorizmit, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, miratimin, kontrollin, si dhe zbatimin e tyre.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i veprimtarive dhe goditja e subjekteve terroriste dhe e atyre që mbështesin dhe e financojnë terrorizmin, duke bllokuar dhe sekuestruar fondet e pasuritë e tyre, sipas rezolutave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuarara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij 1igji, përveçse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. "Bllokim i përkohshëm" është ndalimi i çdo transanksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht, mbeten në pronësi të personave, që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të bllokimit të përkohshëm.

2. "Sekuestrim" është ndalimi i çdo transanksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave, që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të sekuestrimit.

Pas vendosjes së masës të sekuestrimit, organet përgjegjëse ushtrojnë të gjitha të drejtat e kontrollit mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara, përfshirë posedimin, administrimin dhe veprime të tjera, që i çmojnë të nevojshme.

3. "Fond dhe pasuri të tjera" janë pasuritë financiare dhe pronat e çdo lloji, të 1uajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose dixhitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të

udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat, që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

4. "Terrorist" është çdo person fizik, që dyshohet se ka kryer ose ka tentuar të kryejë, në mënyrë të vullnetshme, akte terroriste me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose që ka marrë pjesë si bashkëpunëtor në akte terroriste a në financimin e tyre, që ka organizuar ose drejtuar persona të tjerë për të kryer akte terroriste ose për t'i financuar ato, që ka kontribuar me dashje ose duke pasur dijeni për kryerjen e akteve terroriste apo për financimin e tyre nga një grup personash, që veprojnë për një qëllim të përbashkët.

5. "Subjekt terrorist" është çdo person juridik, çdo formë organizimi a sipërmarrjeje ose një ent tjetër, që zotërohet ose kontrollohet nga terroristët.

6. "Person që financon terrorizmin" është çdo person që siguron a grumbullon, me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, fonde dhe pasuri të tjera, që mund të përdoren tërësisht ose pjesërisht për kryerjen e akteve terroriste apo çdo person që vepron për llogari të këtyre personave, në emër a nën drejtimin e tyre. Në këtë kategori përfshihen personat që ofrojnë ose grumbullojnë fonde dhe pasuri të tjera për t'u përdorur apo që kanë dijeni se do të përdoren për kryejen e akteve terroriste.

7. "Person i shpallur" është çdo person, shtetas shqiptar, i huaj ose pa shtetësi, si dhe çdo person juridik, i regjistruar ose jo, që është cilësuar dhe është përfshirë në listë si terrorist, subjekt terrorist a person që financon terrorizmin ose personat për të cilët janë marrë vendime të ngjashme në mbështetje të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të akteve përkatëse të organizatave ndërkombëtare ose të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

8. "Person i interesuar" është çdo person që ka ose pretendon se ka një të drejtë të ligjshme pronësie a pasurore në fonde dhe pasuritë e tjera të personit të shpallur.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave të shpallur për vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet edhe për vepra penale të terrorizmit, si dhe për fondet e pasuritë e tjera që kanë shërbyer për financimin e terrorizmit, të kryera përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Persona të shpallur

1. Në zbatim të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Ministrave, në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj, vendos përfshirjen në listë të personave të shpallur sipas këtyre rezolutave, si dhe marrjen e masave të nevojshme ndaj tyre.

2. Këshilli i Ministrave mund të vendosë përfshirjen në listë edhe të personave të shpallur nga aktet e organizatave të tjera ndërkombëtare ose nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 6

Masa për fondet dhe pasuritë e tjera të personave të shpallur

Për fondet dhe pasuritë e tjera të personave të shpallur nga Këshilli i Ministrave, sipas këtij ligji, persona të shpallur, Ministri i Financave urdhëron marrjen e një ose të disa prej masave të mëposhtme:

a) bllokimin e përkohshëm;

b) sekuestrimin;

c) ndalimin për t'i dhënë shërbime financiare, fonde, mjete financiare ose pasuri të tjera.

KREU II
ORGANET PËRGJEGJËSE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE PËR TË BASHKËPUNUAR

Neni 7
Organet përgjegjëse për masat kundër financimit të terrorizmit

1. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime për miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së personave të shpallur, sipas nenit 5 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, si dhe për çështje të tjera, që lidhen me masat kundër financimit të terrorizmit.

2. Ministri i Financave është organi përgjegjës për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit dhe për nxjerrjen e zbatimin e akteve për masat e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 8
Administrimi i të dhënave

1. Mbledhja, përpunimi, sistemimi, analiza, ruajtja, përdorimi, shkëmbimi dhe paraqitja e të dhënave për zbatimin e masave kundër terrorizmit, sipas këtij ligji, bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

2. Ministri i Financave, Ministri i Rendit Publik, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe drejtuesit e shërbimeve të tjera informative, sipas fushës dhe përgjegjësive, caktojnë bashkërisht rregullat për njoftimin, mbledhjen, shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave për personat e shpallur, të dhënat ose dyshimet për veprime financiare, transanksione ose veprime të tjera, që kanë për qëllim financimin e terrorizmit.

3. Ministri i Financave kujdeset për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërkombëtar për hetimin, shkëmbimin e të dhënave dhe kryerjen e veprimtarive të tjera për masat kundër financimit të terrorizmit.

Neni 9
Mbledhja e të dhënave

1. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave merr masa për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave për:

a) personat e shpallur;

b) fondet dhe pasuritë e tjera që disponojnë ose lidhen me të drejta a interesa të tjerë të personave të shpallur.

2. Mbledhja, administrimi dhe ruajtja e të dhënave bëhen në formë dokumentare dhe elektronike.

3. Rregullat e hollësishme për administrimin, ruajtjen, klasifikimin e të dhënave, për rastet dhe mënyrën e njoftimit, si dhe për bërjen publike të akteve e të të dhënave, sipas këtij neni, caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 10
Detyrimi për informim dhe raportim

1. Çdo person, që ka dijeni për veprime financiare, transanksione ose veprime të tjera, që kanë për qëllim financimin e terrorizmit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Ministrin e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave ose strukturat e tjera, të ngarkuara me zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

2. Personat e ngarkuar për identifikim dhe raportim, sipas ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave kur kanë të dhëna ose dyshime për veprime financiare, transanksione ose veprime të tjera, që kanë për qëllim financimin e terrorizmit, pavarësisht nga vlera e tyre. Në çdo rast, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave ushtron të drejtat dhe detyrimet përkatëse, të parashikuara në ligjin e përmendur më lart.

3. Njoftimi dhe raportimi, sipas pikës 2, duhet të përmbajnë të dhënat për identifikimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të dhënat për pronësinë dhe interesa të tjerë rreth tyre, si dhe shpjegime për motivet ku mbështeten të dhënat e arsyeshme për financim të terrorizmit.

4. Në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 Ministri i Financave mund të vendosë menjëherë, pa detyrimin e njoftimit paraprak, pezullimin e një operacioni ose transanksioni, për një periudhë deri në 7 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas asaj të hyrjes në fuqi të urdhrit. Njëkohësisht, i njofton menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm të dhënat e nevojshme për këtë transanksion ose veprim, për efekt të procedimit të mundshëm penal.

Neni 11

Mbrojtja e identitetit të personave që japin njoftime

1. Organet përgjegjëse, që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, janë të detyruara të ruajnë anonimatin e personave që kanë dhënë njoftime.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të hollësishme për masat dhe procedurat e ruajtjes së anonimatit të personave që japin njoftime në përputhje me këtë ligj.

Neni 12

Ndalimi i publikimit të të dhënave

1. Të dhënat e siguruara në zbatim të këtij ligji mund të përdoren vetëm për qëllimet e zbatimit të ligjit, për qëllime të ndjekjes penale ose për qëllime të tjera, të caktuara me ligj.

2. Organet përgjegjëse, subjektet e raportimit dhe personat e punësuar pranë tyre, që marrin të dhëna, njoftime dhe raportime në zbatim të këtij ligji, nuk mund të bëjnë publike fakte, për të cilat janë vënë në dijeni gjatë ose për shkak të detyrës.

3. Organet përgjegjëse, subjektet e raportimit dhe personat e punësuar pranë tyre detyrohen t'i vënë në dispozicion gjykatës dokumentet e kërkuara, si dhe të dëshmojnë vetëm në rastet e lejuara në nenin 160 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13

Mbrojtja e subjekteve në mirëbesim

Çdo person, që përmbush ose kërkon të përmbushë në mirëbesim detyrimet, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk mund të paditet, të procedohet penalisht a t'i nënshtrohet një veprimi të ngjashëm ose të vihet para çdo lloj përgjegjësie tjetër për këtë shkak.

KREU III

LISTA E PERSONAVE TË SHPALLUR

Neni 14

Verifikimi i identitetit, i fondeve dhe i pasurive të tjera

1. Ministri i Financave, në bashkërendim me organet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji, bën verifikimin e identitetit të personave që u nënshtrohen procedurave si person i shpallur, si dhe të fondeve e të pasurive të tjera të zotëruara, të kontrolluara ose ku ata kanë ndonjë të drejtë a interes tjetër.

2. Në çastin më të parë të mundshëm, por jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi, organet e përmenduara në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji i paraqesin Ministrit të Financave, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, një raport me shkrim, ku jepen:

a) të dhënat e arsyeshme që personi i shpallur ka të drejta dhe interesa në fondet dhe pasuritë e tjera;

b) pamundësia e vlerësimit brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë, nëse personi i shpallur ka të drejta dhe interesa në fondet dhe pasuritë e tjera.

Neni 15

Kriteret për hartimin e listës së personave të shpallur dhe për marrjen e masave kundër fondeve dhe pasurive të tjera

1. Në rastin e parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji, përcaktimet nga strukturat dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përbëjnë të dhëna të arsyeshme, për të krijuar bindjen se personi është terrorist, subjekt terrorist ose person që financon terrorizmin. Në këto raste Këshilli i Ministrave detyrimisht vendos për përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji Këshilli i Ministrave, në marrjen e vendimit, mbështetet në të dhënat e arsyeshme ku pa u kufizuar vetëm në to, mund të përfshihen aktet e nxjerra nga organizatat ndërkombëtare ose nga marrëveshjet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë. Aktet mund të plotësohen me informacionet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, nga organet e ndjekjes penale, shërbimet informative të shtetit, institucionet e tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në informacione të siguruara nga mbajtësit e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji.

3. Ministri i Financave, mbështetur në dokumentacionin e parashtruar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen në listën e personave të shpallur ose përcaktimin e një personi si person i shpallur, si dhe merr masat për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive të tjera të tij.

4. Masat e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji vendosen për të gjitha fondet dhe pasuritë e tjera ku personi i shpallur ushtron të drejta pronësie, kontrolli ose të drejta a interesa të tjerë.

5. Masat e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji vendosen pavarësisht nga fakti se kush i ka në zotërim a përdorim fondet apo pasuritë e tjera, sikurse edhe për çdo fond dhe pasuri tjetër, që është gjetur në posedim ose mbahet nga persona të shpallur.

6. Zbatimi i masës së bllokimit të përkohshëm ose të sekuestrimit nuk pengon mbledhjen e interesave dhe marrjen e përfitimeve nga fondet dhe pasuritë e tjera. Këto masa shtrihen automatikisht edhe mbi fonde dhe pasuri të tjera që fitohen pas zbatimit të tyre.

7. Nuk lejohen veprime ose transanksione për fondet dhe pasuritë e tjera të bllokuara përkohësisht, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj dhe përcaktimeve të bëra në bazë të tij në aktin përkatës të bllokimit të përkohshëm.

Neni 16

Bllokimi i përkohshëm

1. Ministri i Financave urdhëron menjëherë bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive të tjera të një personi të shpallur edhe përpara nxjerrjes së vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 18 të këtij ligji, kur çmon se kjo është e vetmja mënyrë për të parandaluar shmangien nga zbatimi i masave të parashikuara në këtë ligj ose për të siguruar efektivitetin e tyre.

2. Urdhri i Ministrit të Financave për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 30 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas nxjerrjes së urdhrit.

3. Kur ka të dhëna për kryerjen e një akti terrorist ose për financimin e terrorizmit, Ministri i Financave urdhëron bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera sipas këtij neni dhe njofton menjëherë Prokurorin e Përgjithshëm, duke i dërguar të dhënat e nevojshme për të dyshuarin dhe për fondet e pasuritë e tjera të tij.

Neni 17

Ankimi kundër bllokimit të përkohshëm

1. Kundër urdhrit të Ministrit të Financave për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe të pasurive të tjera, të nxjerrë sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji, personit të interesuar i lind e drejta të bëjë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

2. Gjykata e shqyrton çështjen brenda 10 ditëve, duke zbatuar dispozitat për gjykimet administrative. Në çdo rast, ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të urdhrit të Ministrit të Financave.

3. Personi i interesuar ka detyrimin të provojë para gjykatës se:

a) ka një të drejtë të ligjshme në fondet dhe pasuritë e tjera të personit të shpallur;

b) ka burime të justifikuara ligjërisht për të drejtat dhe interesat e tij në fondet dhe pasuritë e tjera;

c) fondet dhe pasuritë e tjera, objekt gjykimi, nuk kanë lidhje me terroristë, subjekte terroriste, persona që financojnë terrorizmin ose persona të tjerë të lidhur me ta.

4. Personi i interesuar quhet i njoftuar nga data kur ka marrë dijeni për nxjerrjen e urdhrit. Në çdo rast, çështja shqyrtohet brenda afatit të treguar në pikën 2 të këtij neni, nëse Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij paraqet të dhëna të mjaftueshme për pamundësinë e gjetjes së adresës, të vendndodhjes së personit të interesuar ose të pranisë së tij brenda afatit ligjor të shqyrtimit të çështjes.

5. Në rastin e bllokimit të një pasurie të paluajtshme, kopja e urdhrit të bllokimit të përkohshëm dhe e vendimit të gjykatës i dërgohet zyrës që merret me pasuritë e paluajtshme. Kjo e fundit është e detyruar të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të tyre.

Neni 18

Vendimi i Këshillit të Ministrave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, vendos miratimin, ndryshimin ose revokimin e listës së personave të shpallur, për të cilët zbatohen masat kundër financimit të terrorizmit, si dhe për çështjet që lidhen me sekuestrimin e fondeve dhe të pasurive të tyre.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 19

Ankimimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave

1. Personi i shpallur mund të bëjë ankim të veçantë kundër vendimit të Këshillit të Ministrave në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni. E drejta e ankimit mund të ushtrohet vetëm në rastin kur personi pretendon se është identifikuar gabimisht me personin e shpallur.

2. Gjykata e shqyrton çështjen duke zbatuar dispozitat për gjykimet administrative. Në çdo rast ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera, që merren në zbatim të tij.

Neni 20

Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave

1. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, Ministri i Financave merr masa për bllokimin e përkohshëm ose për sekuestrimin e administrimin e të gjitha fondeve dhe pasurive të tjera ose transanksioneve, që kanë të bëjnë me sigurimin e këtyre fondeve dhe të pasurive të tjera të personave të shpallur.

2. Në rastin e sekuestrimit të një pasurie të paluajtshme, kopja e akteve përkatëse dhe e vendimit të gjykatës i dërgohen zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Kjo e fundit është e detyruar të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të tyre.

3. Për administrimin e pasurive të bllokuara e të sekuestruara, sipas këtij ligji, zbatohen dispozitat në fuqi për strukturat përgjegjëse dhe procedurat për fondet dhe pasuritë e sekuestruara të konfiskuara në procedime penale ose jashtë tyre.

Neni 21

Shpenzime të lejuara nga fondet dhe pasuritë e tjera

1. Ministri i Financave, brenda 72 orëve nga paraqitja e kërkesës, autorizon pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara, për t'i përdorur për nevoja mjekësore, familjare dhe vetjake të personit të shpallur, për pagimin e detyrimeve ndaj shtetit ose të atyre që rrjedhin nga puna e kryer dhe sigurimet e detyrueshme.

2. Kundër urdhrit të Ministrit të Financave për refuzimin e autorizimit të kërkuar mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Në çdo rast, ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera që merren në zbatim të tij.

3. Ministri i Financave vendos rregulla dhe procedura të hollësishme për shpenzimet e lejueshme, duke pasur parasysh kriteret e parashikuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Neni 22

Ankimi i personave të interesuar dhe i personave të tretë

1. Personat e interesuar dhe personat e tretë, që pretendojnë se janë në mirëbesim, mund t'i kërkojnë të drejtat e tyre mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara duke bërë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë jo më vonë se 30 ditë nga marrja dijeni për aktin e sekuestrimit. Në çdo rast, ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit dhe të masave të tjera, që merren në zbatim të tij.

2. Personat e interesuar dhe personat e tretë, që pretendojnë se janë në mirëbesim, zbatojnë detyrimet e parashikuara në pikën 3 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 23

Ndryshimi dhe revokimi i vendimit për personat e shpallur

1. Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e vendimit për listën e personave të shpallur brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit të Ministrit të Financave ose mbi ankimin e personit të shpallur, të shoqëruar me shpjegimet për ndryshimin e rrethanave përkatëse, që kanë motivuar nxjerrjen e tij.

2. Efektet e ndryshimit ose të revokimit të masave të marra ndaj personave të shpallur fillojnë shtatë ditë pas datës së botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

3. Ndryshimi ose revokimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për listën e personave të shpallur bëhet vetëm kur vërtetohen rrethana dhe fakte, që e bëjnë të panevojshëm zbatimin e mëtejshëm të tij, për shkak të:

a) një vendimi të mëvonshëm të strukturave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji;

b) një detyrimi që i kërkohet ose i lind Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 25 të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

c) një vendimi përkatës të organizatave të tjera ndërkombëtare ose sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

KREU IV
SANKSIONET

Neni 24

Kundërvajtjet administrative

1. Nëse nuk përbën vepër penale, mospërmbushja nga subjektet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj dhe në 1igjin nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 mijë deri në

10 milonë 1ekë, si dhe me detyrimin në favor të shtetit të vlerës, fondit dhe të pasurisë tjetër, ku vërtetohet se ka një interes personi i shpallur.

2. Dënimet administrative, sipas pikës 1 të këtij neni, vendosen nga Ministri i Financave.

3. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25
Procedimi penal

Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, prokuroria dhe gjykata, në zbatim të dispozitave procedurale penale, mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera, të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara në zbatim të këtij ligji.

Neni 26
Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohen organet përgjegjëse, sipas këtij ligji, që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 9 pika 3, 11 pika 2 dhe 21 pika 3.

Neni 27
Rregulla të brendshme

Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në përputhje me detyrimet përkatëse, autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e përmendura në nenin 3 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, duhet të miratojnë dhe të zbatojnë rregullat e brendshme, të posaçme, për kriteret dhe procedurat e identifikimit të veprimeve, të transanksioneve dhe të personave të dyshimtë për lidhje me financimin e terrorizmit, si dhe për identifikimin e veprimeve financiare, të transanksioneve dhe veprimeve të tjera të dyshimta për financim të terrorizmit.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4281, datë 26.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9259, datë 15.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8932, DATË 26.7.2002 "PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT"

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 fjalët "një togë e Batalionit Special Komando" zëvendësohen me fjalët "një nënrepart i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, së bashku me elementet mbështetëse".

Neni 2

Në nenin 2 fjalët "të togës" zëvendësohen me fjalët "të nënrepartit".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4282, datë 26.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9260, datë 15.7.2004

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7748, DATË 29.7.1993 "PËR STATUSIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Kompensimi financiar i ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që kanë marrë pafajësinë sipas ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar dhe që gëzojnë statusin sipas ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, ish të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë "A", të cilët kanë humbur jetën apo janë të sëmurë psikikë për shkak të përndjekjes ose trashëgimtarit të radhës së parë sipas Kodit Civil, si dhe ish të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë "B" të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr 7748, datë datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, përfitojnë të drejtën e kompensimit financiar në mënyrë të përshkallëzuar mbi bazën e vuajtjes së dënimit si më poshtë:

Periudha e vuajtjes së dënimit	Pagesa mujore në lekë
1 deri në 5 vjet	1 500
5 deri në 10 vjet	2 000
10 deri në 15 vjet	2 500
15 deri në 20 vjet	3 000
20 deri në 30 vjet	3 500
Të pushkatuar	5 000

Neni 2

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

Për zbatimin e këtij ligji ngrihet një komision i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Komitetit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë.

Organizimi dhe funksionimi i këtij komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Pas nenit 21/1 shtohet neni 21/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/2

Kundër vendimeve të Komisionit, të parashikuar në nenin 2 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative””.

Neni 4

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1dhe 2 të tij.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.134, datë 1.7.2004

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PËRBASHKËTA TË OSBE/ODIHR-IT DHE KOMISIONIT TË VENECIAS PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR

Në mbështetje të nenit 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30, 88 dhe 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijohet Komisioni Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias të datës 23 prill 2004 mbi Kodin Zgjedhor.

II. Komisioni Parlamentar përbëhet nga 16 anëtarë, mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë, nga të cilët 8 anëtarë janë përfaqësues të pozitës dhe 8 anëtarë janë përfaqësues të opozitës. Nga gjiri i vet, Komisioni zgjedh, me mirëkuptim midis grupeve parlamentare, dy bashkëkryetarë dhe sekretarin.

III. Komisioni Parlamentar do të fillojë nga veprimtaria e tij në datën e miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi dhe do të përfundojë brenda 2 muajve nga krijimi i tij.

IV. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash dhe quhen të miratuara kur votojnë "pro" përfaqësuesit e dy partive më të mëdha parlamentare.

V. Komisioni vepron sipas procedurës së përcaktuar për komisionet e përhershme në nenet 52 deri në 68 të Rregullores së Kuvendit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.135, datë 5.7.2004

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.134, DATË 1.7.2004 "PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PËRBASHKËTA TË OSBE/ODIHR-IT DHE KOMISIONIT TË VENECIAS PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR"

Në mbështetje të nenit 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30, 88 dhe 164 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.134, datë 1.7.2004 "Për krijimin e Komisioni Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor", në pikën II shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në përbërje të Komisionit Parlamentar caktohen:

Elmaz Sherifi
Ylli Bufi
Maqo Lakrori
Petro Koçi
Sotir Kokeri
Jemin Gjana
Sokol Olldashi
Fatos Beja
Luigj Gjoka
Preç Zogaj
Nard Ndoka
Ekrem Spahia".
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Makbule Çeço

VENDIM
Nr.136, datë 8.7.2004

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 6 pika 6 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e mbledhjes së përfaqësuesve të pushtetit vendor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Shahin Bistri zgjidhet anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Makbule Çeço

VENDIM
Nr.137, datë 8.7.2004

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Raimond Cimbi zgjidhet anëtar i Komisionit të Konkurrencës.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Makbule Çeço

VENDIM
Nr.138, datë 15.7.2004

PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZONJËS VITORE TUSHA ANËTARE E GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125 të Kushtetutës dhe të nenit 92 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.4251, datë 24.6.2004,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Vitore Tusha anëtare e Gjykatës Kushtetuese në vend të zotit Zija Vuci, të cilit i ka mbaruar mandati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.139, datë 22.7.2004

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR PËRGATITJEN E PROJEKTLIGJIT "PËR NDARJEN E RE ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Kuvendit për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijohet Komisioni i Posaçëm i Kuvendit për përgatitjen e paketës ligjore për reformën e re administrativo-territoriale dhe për përgatitjen e projektligjit "Për ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë".

II. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit përbëhet nga 16 anëtarë mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë, nga të cilët 8 anëtarë janë përfaqësues të pozitës dhe 8 anëtarë janë përfaqësues të opozitës. Komisioni kryesohet nga 2 bashkëkryetarë, një nga pozita dhe një nga opozita, të cilët zgjidhen nga Komisioni në mbledhjen e tij të parë. Komisioni zgjedh nga gjiri i tij edhe sekretarin e Komisionit.

III. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit do të fillojë nga veprimtaria në datën e konstituimit të tij dhe mbaron veprimtarinë më 30.4.2005.

IV. Pranë Komisionit të Posaçëm të Kuvendit ngrihet dhe funksionon grupi i ekspertëve, numri, afatet e punës dhe detyrat specifike të të cilëve përcaktohen me vendim të Komisionit. Në përbërje të tij ky Komision ka edhe sekretarinë teknike me ekspertë nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

V. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit vepron sipas procedurës së përcaktuar për komisionet e përhershme në nenet 52-68 të Rregullores së Kuvendit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.140, datë 29.7.2004

PËR MOSMIRATIMIN E NJË KANDIDATURE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 «Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë» , i ndryshuar, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë propozimin e Presidentit të Republikës për zgjedhjen e zotit Lutfi Dervishi në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.141, datë 29.7.2004

PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 «Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë» , i ndryshuar, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Sefedin Çela dhe zoti Halil Lalaj zgjidhen në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.142, datë 29.7.2004

PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" , i ndryshuar, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Visar Zhiti dhe zoti Agim Duro zgjidhen në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.491, datë 23.7.2004

PËR SHPËRNDARJEN ME KOEFICIENT TË VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE TË SHOQËRISË "KAMBERI CO" SHPK, NË ADMINISTRIM ME TË ADHURAT E REALIZUARA NGA SHITJA E ASETEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë "Kamberi Co" sh.p.k., në administrim, sipas koeficientit të kthimit të shumave, të llogaritur si raport i të ardhurave të realizuara dhe të depozituara në bankë nga shitja e aseteve dhe e shumës së detyrimit të shoqërisë ndaj kreditorëve, si më poshtë vijon:

1.1 Të ardhurat financiare, të realizuara nga shitja e aseteve të shoqërisë "Kamberi Co" sh.p.k., në administrim dhe të depozituara në bankë, në llogari rrjedhëse dhe llogari depozite janë 587 000 000 (pesëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse "Kamberi Co" sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve 5 798 129 817 (pesë miliardë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

1.3 Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve është 10,2 për qind.

2. Shpërndarja e vlerave financiare të kryhet nga degët e bankës së kursimeve në rrethet Vlorë, Tiranë, Fier dhe Sarandë, sipas një marrëveshjeje të veçantë, që do të lidhet ndërmjet grupit mbikëqyrës dhe kësaj banke. Shpërndarja e vlerave financiare kreditorëve fillimisht të kryhet me mjetet monetare, gjendje në llogarinë rrjedhëse, dhe më pas me vlerat financiare të llogarisë depozitë, sipas kërkesës së paraqitur nga administratori i pavarur i shoqërisë në bankën e kursimeve, në fund të çdo tremujori.

3. Shpenzimet për shërbimet në sportelet e bankës së kursimeve, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë "Kamberi Co" sh.p.k., në administrim, të përballohen nga plani financiar i grupit mbikëqyrës, zëri "Shpenzime", në përfundim të shlyerjes të vlerave financiare kreditorëve.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, grupi mbikëqyrës dhe administratorët e pavarur të shoqërisë "Kamberi Co" sh.p.k., në administrim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.3, datë 18.3.2004

PËR FORMAT DHE PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE TË RAPORTIMIT NGA ORGANET, QË LICENCOJNË PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË, NË FUNKSION TË PROCESIT TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10/2 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Organet licencuese të kryejnë identifikimin e personave, që kërkojnë të licencohen, para dhënies së licencës për të gjitha veprimet, për shuma nga 2 000 000 (dy milionë) lekë a kundërvlerën e tyre në monedha të tjera, sipas kërkesave të nenit 4 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar.

Personat fizikë dhe juridikë, të identifikohen edhe në rastet kur ka të dhëna ose dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete, për pastrim parash edhe për vlera financiare nën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Organet licencuese të krijojnë dosje të veçanta dhe të regjistrojnë në to të gjitha të dhënat identifikuese të personave, që kërkojnë të licencohen ose që janë licencuar.

Në këtë dosje të përfshihen të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Për personin fizik, jotregtar, individ: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin e përkohshëm a të përhershëm, numrin dhe llojin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe organin që e ka lëshuar atë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në këto të dhëna, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

b) Për personin juridik: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, numrin e lejes së ushtrimit të veprimtarisë nga organet tatimore, selinë, e përkohshme a të përhershme, objektin e veprimtarisë tregtare, qëllimin, llojin, datën, shumën dhe monedhën me të cilën kryhet veprimi financiar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

c) Për përfaqësuesin ligjor të klientit që do të licencohet: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe lëshuesin e këtij dokumenti, aktin e përfaqësimit (prokurën), si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në këto të dhëna, deri në çastin e kryerjes së veprimit financiar.

3. Dokumentacioni i identifikimit të të gjithë personave fizikë a juridikë, që do të licencohen, të ruhet për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënieve juridike, civile me ta.

4. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës" për çdo dyshim të bazuar, për burimin ose origjinën e kapitalit, natyrën e veprimit financiar etj pavarësisht nga vlera e përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar, për parandalimin e pastrimit të parave, në rastet:

a) kur kanë dyshime të bazuara në fakte e rrethana konkrete, që mund të lidhen me parregullsi në dokumentacionin, identifikues dhe justifikues, të burimit të ligjshëm të kapitaleve me ato reale;

b) kur vërejnë parregullsi në deklarimin e burimeve të të ardhurave ose të kapitaleve, si dhe kur dyshojnë për burimet e pasurisë ose të parave të deklaruara a lidhje me veprimtari penale;

c) kur vërejnë mosjustifikim të pasurisë a të parave të deklaruara nga pikëpamja ekonomike apo ligjore;

ç) kur ka informacione, sinjalizime a të dhëna se paratë ose pasuritë e depozituara për licencimin rrjedhin nga vepra penale ose janë të përziera me para ose pasuri të tilla apo kur dyshojnë

se veprimtaria, për të cilën kërkohet të licencohen, do të ngrihet për të realizuar ose mbështetur pastrimin e parave etj.

d) kur vërejnë mosdeklarim të burimit të kapitalit ose të të ardhurave;

e) kur kanë dyshime të tjera, të bazuara në gjendjen ose rrethanat, të cilat nuk janë parashikuar më lart.

Për çdo rast dyshimi, raportimi të bëhet sipas aneksit 1 "Formulari i sinjalizimit për persona që licencohen", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

5. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës" për personat që paraqesin kërkesën për licencim, përpara dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, për çdo veprim financiar mbi 20 000 000 (njëzet milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera, sipas aneksit 2 "Formulari i veprimeve financiare për personat fizikë dhe juridikë që licencohen", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

6. Organet licencuese të kërkojnë deklarimin e burimit të ligjshëm të kapitaleve dhe sqarime të mëtejshme për paqartësi rreth identifikimit të personit fizik ose juridik, administratorit, ortakëve dhe burimeve, si dhe të bëjnë verifikime për kapitalin fillestar të personave fizikë a juridikë për të qartësuar burimin e krijimit të këtij kapitali për ushtrimin e veprimtarisë.

7. Organet licencuese të raportojnë tek "autoriteti përgjegjës", menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për të gjitha rastet e parashikuara më sipër, si dhe për çdo të dhënë tjetër, që vërteton ose kundërshton të dhënat e bazuara në fakte ose rrethana konkrete a dyshime për pastrim parash, me faks, e-mail, telefon, korrier, duke e shoqëruar me një raport zyrtar, me shkrim

8. Organet licencuese të njoftojnë "autoritetin përgjegjës" në të njëjtën mënyrë, në çdo rast kur kanë të dhëna ose dyshime për implikime ose qëllime, që veprimtaria do të përdoret për të mbështetur, lehtësuar, ruajtur, nxitur ose fshehur akte terroriste apo do të financojë terrorizmin.

9. Organet licencuese të caktojnë një drejtues të nivelit të lartë, tek i cili nëpunësit dhe punonjësit, që merren me procesin e licencimit, të raportojnë të dhëna të mjaftueshme, që mund të shërbejnë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 5 të ligjit, për parandalimin e pastrimit të parave.

10. Organet licencuese të sigurojnë krijimin e një qendre për grumbullin e të dhënave për parandalimin e pastrimit të parave, sipas detyrimit të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000.

11. Organet licencuese të hartojnë programe kontrolli për testimin e sistemit dhe të bashkëpunojnë me organet e kontrollit të brendshëm të institucionit, për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

12. Organet licencuese t'i dërgojnë "autoritetit përgjegjës", në afatet e përcaktuara, të dhënat shtesë dhe dokumentet e kërkuara. Kur ka arsye të bazuara se afati i caktuar është i pamjaftueshëm, kërkohet zgjatja e tij, por jo më shumë se 15 ditë nga marrja e kërkesës.

13. Në përputhje me detyrimet përkatëse ligjore dhe sipas fushës së veprimtarisë, organet licencuese të përgatisin dhe të zbatojnë rregullore dhe udhëzime të brendshme, për të vlerësuar dhe identifikuar transaksionet e lidhura me veprimtari të paligjshme.

15. Organet licencuese, që përcaktohen në nenin 10/2 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar dhe punonjësit e drejtuesit e çdo niveli, që ngarkohen me raportimin e transaksioneve të dyshimta, në zbatim të nenit 6 të ligjit, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe ndalohen të njoftojnë subjektet, që do të licencohen, për procedurat e verifikimit, dyshimet dhe për çdo të dhënë tjetër për pastrimin e parave.

16. Organet licencuese detyrohen t'i mbajnë dhe t'i ruajnë raportimet për veprimin financiar të subjektit, që do të licencohet, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

17. Organet licencuese, në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000, të ndryshuar, janë të detyruara të zbatojnë urdhrat e "autoritetit përgjegjës" për bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit a të veprimit financiar, për një periudhë jo më tepër se 72 orë, në rastet e licencimit, kur subjekti që licencohet kryen pagesën e kapitalit themeltar ose shtimin e kapitalit.

Aneksi 1

Emri i organit licencues_____

Konfidenciale

FORMULARI I SINJALIZIMIT PËR PERSONAT QË LICENCOHEN

Nr._____, datë____/____/200____.

a) Klienti të cilit i referohet veprimi i licencimit.

Emri i personit fizik ose juridik_____.

Adresa(vendbanimi ose selia)

e përkohshme_____.

E përhershme_____.

Dokumenti eventual i identifikimit_____.

Arsyeja e kryerjes së veprimit financiar: a)derdhje kapitali, b) rritje kapitali_____.

c) të tjera (specifika) _____.

b)Veprimtaria për të cilën klienti kërkon të licencohet ose është licencuar.

_____
____.

c) Sasia dhe lloji i monedhës së përdorur në kryerjen e veprimit financiar.

-Lloji_____

-Shuma(me shifra dhe me fjalë)_____.

-Data _____,_____,200___.

d) Motivi i dyshimit

_____
__.

_____
____.

e) Shënime eventuale shtesë

_____
____.

_____
____.

_____
____.

P.s.Ky formular dërgohet tek “autoriteti përgjegjës” menjëherë së bashku me “Formularin e veprimeve financiare të personave fizikë dhe juridikë që licencohen”. Bashkëlidhur të shoqërohet dhe me një raport të hollësishëm ku të sqarohen të gjithë elementet e dyshimit.

= Aneks 2 =

FORMULARI I VEPRIMEVE FINANCIARE PER PERSONAT FIZIKE DHE JURIDIKE QE LICENSOHEN.

I. Identifikimi I personiti cili kryen veprimin financiar per tu licensuar.

1. Person fizik jotregetar (individ)

Emri

Mbiemri

Datelindja

Vendlindja

Vendbanimi

Numri dhe lloji I dokumentit zyrtar te identifikimit

2. Person juridik

Emri

Nr.dhe dt.e vendimit te gjykates per rregj.si person juridik

Nr.I lejes se ushtrimit te veprim.nga org.tatimore

Selia e perkoheshme ose e perhereshme

Natyra e veprimtarise qe do te ushtroje

3. Perfaqesuesi i personit juridik (sipas statusit te shoqerise)

Emri

Atesia

Mbiemri

Datelindja

Nr.i dokumentit zyrtar te identifikimit

Akti i perfaqesimit (prokura)

II. Tipi i veprimit financiar.(Kapitali themeltar) 1.Ngrirje __ 2. Pagese __ 3. Premtim per tu paguar __ 4.Te tjera. Specifiko _____

a) Banke Nr. Mandat pagese Urdherxhirimi

b) Cash U$D LEK EURO

c) Check Nr.check Banka emetuese

III. Qellimi I veprimit financiar per licensim.

Pershkruaj _____

IV. Vlera e transaksionit.

U$D EURO LEK Te tjera

Burimi i deklaruar i kesaj shume _____

V. Organi Licensues

a) Emri..... b) Personi pergjegjes

c) Data d) Tel & Fax

e) Adresa

VULA

Organet licensuese i raportojne "autoritetit pergjegjes" per te gjithe shumat mbi 20 milion leke si edhe per te gjitha veprimet financiare kur ka elemente te dyshimit per pastrim parash, jo me vone se 72 ore pas regjistrimit te veprimit.

18. Ngarkohen "autoriteti përgjegjës", organet që licencojnë personat fizikë dhe juridikë, dhe institucionet nga të cilat varen këto organe për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

AUTORIZIM ZYRTAR

PËR TË VEPRUAR SI SHOQËRI SIGURIMI
Nr.7, datë 8.7.2004

Në mbështetje të nenit 17 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" (i ndryshuar) dhe pikave 4 dhe 4.2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.229, datë 28.4.1999 "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të mbikëqyrjes së sigurimeve" Komisioni i Mbikëqyrës së Sigurimeve

AUTORIZON:

Shoqërinë "Dukagjini AL" sh.a., me seli në Tiranë, të ushtrojë veprimtari sigurimi për jo-jetën (dëmet), në përputhje me lejen për ushtrim veprimtarie.

KRYETAR
Gëzim Agasi

UDHËZIM
Nr.2, datë 19.7.2004

MBI PËRCAKTIMIN DHE PLOTËSIMIN E MODELIT TË REGJISTRIT TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4 2004 “Për shërbimin publik të varrimit “, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit

UDHËZON:

1. Regjistri i shërbimit të varrimit është dokumenti përmbledhës i të dhënave të shërbimit të varrimit.

2. Modeli i regjistrit të shërbimit të varrimit është unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë, sipas modelit tip që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Në këtë regjistër shënohen të dhënat e sakta për varrimet që kryhen, mënyrën e varrimit, ndryshimin që ka ndodhur si pasojë e zhvarrosjeve, si dhe të dhëna në plotësim të kërkesave të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”.

4. Drejtoria, sektori apo zyra që mbulon veprimtarinë e shërbimit të varrimit të çdo bashkie ose komune bën administrimin e këtij regjistri.

5. Përgjegjësi i drejtorisë, i sektorit apo i zyrës përkatëse të bashkisë apo komunës i jep me procesverbal dy kopje të njëjta të regjistrit të shërbimit të varrimit, me numër të njëjtë fletësh dhe të nënshkruara nga kryetari ose sekretari i bashkisë apo komunës, ndërmarrjes ose shoqërisë private të licencuar që administron varrezat.

6. Ndërmarrja apo shoqëria private e licencuar që administron varrezat, plotëson regjistrin e shërbimit të varrimit, sipas kërkesave të nenit 7 të ligjit nr.9220, datë 15.4.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”.

7. Plotësimi i regjistrit bëhet nga një person i ngarkuar me këtë detyrë, bazuar në lejen e varrimit ose deklarimit të personave madhorë të familjes së të ndjerit sipas nenit 50 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile".

8. Plotësimi i regjistrit do të bëhet me shkrim të qartë dhe pa korrigjime, duke regjistruar të dhënat si më poshtë vijon:

a) të dhënat e sakta të identifikimit që merren nga gjendja civile nëpërmjet lejes së varrimit;

b) të dhënat e varrosjes si data, ora dhe numri i faturës;

c) lloji i varrimit kur kemi varrim nëntokësor, mbitokësor ose zhvarrim;

d) vendi i vendosjes me të dhënat që identifikojnë pozicionin e varrit në varrezat publike;

e) ndryshimet që mund të bëhen si rezultat i zhvarrimeve ose për vdekjet nga sëmundjet infektive, varrim i cili kryhet në kushte të veçanta.

Në rastet kur gjatë plotësimit të regjistrit bëhen gabime, korrigjimi i tyre bëhet sipas mënyrës së korrigjimit të regjistrave të gjendjes civile, konform nenit 27 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile".

9. Kontrolli ditor i regjistrimeve, në këtë regjistër, bëhet nga përgjegjësi i shërbimit të varrimit duke firmosur në çdo fletë mbas mbushjes të saj.

10. Ndërmarrja ose shoqëria private e licencuar e administrimit të varrezave duhet të bëjë rregullisht rakordimin e regjistrit të plotësuar nga ajo, me regjistrin themeltar të zyrës së gjendjes civile që ka lëshuar lejen e varrimit. Në rast të mospërputhjes të regjistrave, veprohet konform nenit 51 të ligjit nr.8950,datë 10.10 2002 "Për gjendjen civile".

11. Një kopje regjistri e plotësuar dorëzohet çdo fund viti në bashki ose komunë, ndërsa kopja tjetër mbetet pranë ndërmarrjes ose shoqërisë private të administrimit të varrezave. Kontrolli i të dhënave të regjistruara dhe i mënyrës së plotësimit të tyre, bëhet nga organet përkatëse të pushtetit vendor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Bashkim Fino

RREGJISTER I SHERBIMIT TE VARRIMIT

Nr.	Emri Atesia Mbiemri	Mosha	Vendi i lindjes	Data e lindjes	Varrosja					Lloji i varrimit	Vendi i Vendosjes			Ndryshimet
					Dita	Muaji	Viti	Ora	Nr.i fat.		Parcela	Rradha	Nr.	

LLOJI I VARRIMIT : NENTOKESOR, MBITOKESOR, ZHVARRIMI

UDHËZIM
Nr.3, datë 28.7.2004

PËR ADMINISTRIMIN E UJIT TË PIJSHËM

Në mbështetje të vendimit nr.236, datë 10.5.1993, të Këshillit të Ministrave "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë" dhe vendimit nr.550, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikave "Decentralizimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet" dhe masat për zbatimin e tij"".

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Mënyrat dhe format e dhënies së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve zgjidhen nga pushteti vendor në përputhje me kushtet specifike dhe interesat e komunitetit. Format për dhënien e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, janë të përcaktuara me vendimin nr. 550, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikave "Decentralizimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet" dhe masat për zbatimin e tij"".

2. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të përdorura bëhet nga sh.a. ujësjellës-kanalizime, koncensionari si shoqëri menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, të licencuara në bazë të kontratave të shitjes që lidhen ndërmjet palëve. Njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë kompetenca rregullatore gjatë këtij procesi.

3. Ujësjellësit që shërbejnë për furnizimin e fshatrave të një komune ose të një bashkie administrohen nga vetë njësitë e qeverisjes vendore, me përjashtim të rasteve kur komuna ose bashkia, miraton administrimin me një nga format e parashikuara në dokumentin e politikave për decentralizimin e ujësjellës-kanalizimeve.

4. Pas aparatit matës instalimi i ujit administrohet nga konsumatori familjar dhe konsumatori jofamiljar shtetëror ose privat.

5. Njësitë e qeverisjes vendore që marrin ujë të pijshëm nga degëzimet e ujësjellësve të qytetit përgjigjen vetë për mirëfurnizimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit nga pika e lidhjes deri tek konsumatori. Njësitë e qeverisjes vendore mbi bazën e sasisë të ujit që marrin sipas normave të regjistruara në matës, likuidojnë sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqërinë menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjen e uiësjellës-kanalizimeve.

II. VENDOSJA E APARATEVE MATËS TË UJIT

1. Lidhja për furnizimin me ujë të pijshëm e konsumatorit bëhet nga administratori i rrjetit ose menaxhuesi i shoqërisë, kur rrjeti i konsumatorit është ndërtuar sipas projektit të miratuar nga administratori dhe plotëson kushtet teknike e sanitare.

2. Konsumatorët jofamiljarë shtetërorë ose privatë që furnizohen me ujë të pijshëm, i sigurojnë vetë matësit e ujit. Administratori ose menaxhuesi përcakton tipin dhe projektin e vendosjes. Vendosja kryhet me shpenzimet e konsumatorit nën mbikëqyrjen e administratorit midis të cilëve hartohet procesverbali dhe lidhet kontrata ndërmjet palëve.

3. Matësit e ujit për konsumatorët familjarë, instalohen nga administratori ose menaxhuesi i rrjetit mbi bazën e marrëveshjes ndërmjet palëve ku parashikohet edhe mënyra e pagesës si rezultat i vendosjes së tyre.

4. Administrimi dhe ruajtja e matësit të ujit, bëhet nga konsumatorët jofamiljarë shtetërorë ose privatë. Në rast dëmtimi të tyre, konsumatori duhet të njoftojë me shkrim administratorin ose menaxhuesin e shoqërisë dhe të marrë masa për zëvendësimin e tij brenda afateve të parashikuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993.

5. Në rast se konsumatori nuk zbaton afatet për zëvendësimin e matësit dhe nuk paguan gjobat e parashikuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993 administratori ose menaxhuesi, ndërpret furnizimin me ujë dhe kontrata ndërmjet palëve konsiderohet e zgjidhur.

6. Konsumatori në bazë të kontratës së lidhur me sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqërinë menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, duhet të paguajë për konsumin e ujit të pijshëm. Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, me ndryshimet përkatëse "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e saj.

III. NDËRHYRJET NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT

1. Përdoruesi i ujit të pijshëm nuk lejohet të bëjë shtesë të rrjetit të ujësjellësit që sjell harxhim të ujit pa marrë më parë leje nga sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, shoqëria menaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrja e ujësjellës-kanalizimeve dhe njësia e qeverisjes vendore.

2. Punimet e lidhjes së ujit kryhen në prezencë të administratorit ose menaxhuesit të shoqërisë, kur përdoruesi i ujit është brenda vijës kufizuese të planit rregullues të qytetit apo fshatit.

3. Administratori ose menaxhuesi i ujësjellesve dhe kanalizimeve për meremetimet e planifikuara në rrjetin e jashtëm dhe të brendshëm të furnizimit me ujë është i detyruar të lajmërojë 15 ditë më parë përdoruesit e ujit, nëpërmjet medias dhe personelit të tij.

4. Sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqëria menaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrja e ujësjellës-Kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore në mënyrë periodike me anë të punonjësve ose teknikëve të autorizuar prej tyre, duhet të kontrollojnë rrjetin e ujësjellësve dhe kur vërejnë mangësi të instalimeve dhe ndërhyrje në rrjet, të marrin masa të menjëhershme për riparimin e tyre, duke vënë përpara përgjegjësisë subjektet të cilat kanë ndërhyrë në rrjet pa miratimin e strukturave përgjegjëse.

5. Ndërtesat e banimit të projektohen detyrimisht me instalime të brendeshme të ujit të pijshëm dhe aparate matëse të ujit. Ato të vendosen në vende të dukshme dhe të siguruara. Për rastet e ndërtimeve të reja aparati matës i ujit instalohet nga subjekti ndërtues, pas miratimit nga administratori ose menaxhuesi i shoqërisë.

IV. MBROJTJA E VEPRAVE DHE SIGURIMI HIGJIENO-SANITAR I UJIT TË PIJSHËM

1. Mbrojtja higjieno-sanitare e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm përfshin të gjitha veprat e ujësjellësit, prej zonës së ushqimit, zonës së vendburimit e deri te përdoruesit e ujit. Administruesit e ujit të pijshëm, duhet të bëjnë klorinimin e ujit sipas ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 "Për inspektoratin sanitar shtetëror". Në rastet e situatave të jashtëzakonshme me karakter epidemiologjik, kur ka rrezik për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, drejtoritë e shëndetit publik dhe të epidemiologjisë në qarqe caktojnë dozën e klorit të nevojshëm.

2. Administratorët e ujit pasi kanë marrë edhe miratimin e inspektoratit sanitar realizojnë mbrojtjen higjieno-sanitare të vendburimeve dhe depove të ujit sipas kushteve lokale:

- brezi i rreptësisë i cili rrethohet dhe bëhet i pakalueshëm, ky brez përfshin të gjitha veprat e marrjes së ujit, si kaptazhe, depo uji, stacione pompimi, vaska grumbulluese e klorifikimi; në këtë zonë ndalohet çdo ndërtim, përveç atyre të domosdoshme për nevoja të ujësjellësit;
- brezi i mbikëqyrjes epidemiologjike, ku vendoset kontrolli shëndetësor dhe epidemiologjik edhe mbi popullsinë që banon në këtë zonë.

3. Ndotja e ujit të pijshëm si rezutat i ndërhyrjes në objektet e ujësjellësit formon vepër penale. Struktura përgjegjëse (inspektori i kontrollit dhe punonjësi i autorizuar) mban procesverbal dhe bën kallëzimin për ndjekje penale.

V. KONSTATIMI I LIDHJEVE DHE PËRDORIMI I UJIT NË MËNYRË TË PALIGJSHME

1. Përdoruesi i ujit për dëmtimet në rrjetin e brendshëm pas aparatit matës, merr masa të menjëhershme për ndreqjen e tyre.

2. Ndalohet çdo lloj manovrimi në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimeve nga persona që nuk janë të autorizuar nga administratori ose menaxhuesi i shoqërisë.

3. Ndalohet kategorikisht ndërtimi i objekteve mbi tubacionet e furnizimit me ujë dhe kanalizime, si dhe ndërhyrjet në sistemin e ujësjellësit e kanalizimit, lidhjet e pa miratuara nga manaxhuesi i licencuar dhe dëmtimet e çdo lloji.

4. Ndalohet kategorikisht përdorimi i ujit të pijshëm për lavazhet, ujitjen e tokës bujqësore, lagien e trotuareve dhe rrugëve, nevoja teknologjike që nuk janë parashikuar në projekte.

5. Administratori ose menaxhuesi i shoqërisë për kundërvajtjet që konstaton gjatë shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve, bashkërendon punën me njësinë e qeverisjes vendore, policinë e rendit, policinë ndërtimore dhe policinë bashkiake, duke marrë masa administrative apo denoncon për ndjekje penale për shkeljet e dispozitave që rregullojnë marrëdhëniet e shërbimit dhe furnizimin me ujë.

6. Sh.a. ujësjellës-kanalizime, shoqëria manaxhuese e ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellësave, duhet të kenë struktura të veçanta për ruajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimin e ujrave të përdorura nga ndërhyrjet e paligjshme. Konstatimet për ndërhyrjet apo përdorimin në mënyrë të paligjshme bëhen nga inspektori i kontrollit dhe punonjësi i autorizuar, të cilët kanë autoritetin e vendosjes së gjobave të parashikuara në vendimit e Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993. Konstatimi, shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative apo ekzekutimi i vendimeve, kundër personave përgjegjës, që kryejnë kundërvajtje administrative bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

7. Ankimi kundër dënimit të marrë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 10.5.1993, për shkeljet e konstatuara në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, bëhen tek drejtori i ndërmarrjes së sh.a. Ujësjellës-Kanalizime, shoqërisë menaxhuese të Ujësjellës-Kanalizimeve ose ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve. Pas marrjes së vendimit nga drejtori, subjekti ka të drejtë të ankohet në gjykatën e shkallës së parë në bazë të nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile.

8. Kur shkeljet e konstatuara formojnë vepër penale, struktura përgjegjëse (inspektori i kontrollit dhe punonjësi i autorizuar) mban procesverbalin dhe bën kallëzimin për ndjekje penale në bazë të nenit 159 të Kodit Penal.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Bashkim Fino

Fletorja Zyrtare gjendet:
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
  Bulevardi "Zhan d'Ark", pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE 1500

Doli nga shtypi më 11.8.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë